



Java Kundër  
**KORRUPSIONIT**  
9-14 DHJETOR 2018



# VETINGU PA ALTERNATIVË



Analizë e “kapjes” së Policisë, Prokurorisë  
dhe Gjyqësorit nga politika dhe grupet e  
interetit në Kosovë

**#IKD #GLPS #ÇOHU #INPO**  
**#GAP #COLUMBUS #KIPRED #ACDC**

Prishtinë, dhjetor 2018

Autorë:           Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) dhe  
                      Instituti Columbus

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e autorëve.

*“Ky projekt u financua përmes grantit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit”.*

Dizajn: Anymate

Përmbajtja	
I.	Hyrje.....4
II.	Integriteti i Institucioneve të Drejtësisë dhe Sigurisë.....6
III.	Kapja e institucioneve të drejtësisë dhe sigurisë – analizë e rasteve konkrete.....7
1)	Rasti Blakaj: Ndërhyrjet politike dhe të Kryeprokurorit në rastin e veteranëve dhe prontos.....8
2)	Deportimi i gjashtë shtetasve turq nga Kosova .....11
3)	Vendimi i Qeverisë për rritjen e pagave dhe zvarritja e hetimeve nga prokuroria.....14
4).	Dështimi i Policisë: Vjedhja e dhomës së dëshmive.....17
4.1)	Vjedhja në Dhomën e Dëshmive në Drejtorinë e Krimit të Organizuar në Polici.....17
4.2)	Vjedhja në Dhomën e Dëshmive në Polici në Pejë.....18
5)	Përpjekjet për të amnistuar djalin e dyshuar të Shefit të AKI-së Shpend Maxhuni .....19
6)	Sistemi i sigurisë dhe drejtësisë i pafuqishëm përballë rasteve të dhunës në familje.....21
6.1.	Rasti i Valbona Markut.....22
6.2.	Rasti i Diana Kastratit.....23
IV.	Joefikasiteti i sistemit të drejtësisë në trajtimin e rasteve.....24
1.	Trajtimi i rasteve të profilit të lartë të korrupsionit .....26
1.1)	Enver Hasani, ish – Kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës .....27
1.2)	Enver Hasani, ish – Rektori i Universitetit të Prishtinës.....28
1.3)	Sali Mekaj, ish – Kryetar i Gjykatës së Apelit të Kosovës.....30
1.4)	Shpresa Bakija, ish – Kryeprokurore e Prokurorisë Themelore në Gjakovë.....31
1.5)	Mazllum Baraliu, ish – Rektori i Universitetit të Prizrenit.....32
1.6)	Nuhi Uka, ish – Kryetar i Gjykatës Themelore në Prishtinë .....32
1.7)	Shaban Buza, Rektori i Universitetit të Gjakovës.....34
1.8)	Hysni Hoxha, ish – Kryetar i Organit Shqyrtues të Prokurimit.....34
1.9)	Shyqyri Haxha, ish – Drejtor Ekzekutiv i Postës dhe Telekomit të Kosovës.....36
1.10)	Driton Gashi, ish – Shef i Agjencisë së Inteligjencës së Kosovës .....37
V.	Mungesa e llogaridhënies praktike të gjykatësve dhe prokurorëve .....37
1.	Performanca e gjykatësve dhe prokurorëve.....38
1.1)	Vlerësimi i performancës së gjyqtarëve nga KGJK-ja.....38
1.2)	Vlerësimi i performancës së prokurorëve nga KPK-ja.....39
2.	Disiplinimi i gjykatësve dhe prokurorëve.....40
2.1)	Komisioni Disiplinor i KGJK-së .....41
2.2)	Komisioni Disiplinor i KPK-së.....41
2.3)	Raportimi i kryetarëve të Gjykatave në KGJK.....42
2.4)	Raportimi i kryeprokurorëve në KPK.....42
VI.	Protestat qytetare për vetingun në drejtësi.....43
VII.	Vetingu pa alternativë për gjykatësit, prokurorët dhe policët.....44

## I. Hyrje

Sistemi i drejtësisë në Kosovë prej përfundimit të luftës në vitin 1999 është përballur me probleme dhe sfida të shumta në rrugën drejt funksionimit dhe pavarësisht nga pushtetet e tjera. Përpjekja e parë në Kosovë për ta pastruar sistemin e drejtësisë prej gjykatësve dhe prokurorëve me integritet të kontestuar, ishte bërë menjëherë pas shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës më 17 shkurt 2008. Sistemi gjyqësor dhe prokurorial, iu nënshtroan një procesi të riemërimit dhe emërimit të gjykatësve dhe prokurorëve. Ky proces i riemërimit dhe emërimit, përfshinte një veting, në të cilin gjykatësit dhe prokurorët, vlerësoheshin dhe rekomandoheshin për emërim në bazë të meritave, përfshi përvojën dhe integritetin personal dhe profesional. Sipas raportit të Komisionit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial, në përbërje të ndërkombëtarëve, në fund të këtij procesi të verifikimit, kishte 334 të emëruar, prej tyre 274 gjykatës dhe 60 prokurorë.<sup>1</sup>

Prej vitit 2010 e deri më tash, sistemi i drejtësisë, përfshi Policia, Prokuroria dhe Gjyqësori janë përfshirë në shkelje të shumta ligjore dhe skandale të përmasave të mëdha, të cilat e kanë ulur besimin e qytetarëve në këto institucione. Sistemi i organit të ndjekjes në shumë segmente ka dështuar në ndjekje të kryerësve të krimeve, sidomos kur bëhet fjalë për profilin e lartë. Zyrtarët e lartë shtetërorë si përfaqësues politik, jo në aspektin formal, por në aspektin praktik janë ndikuesit e drejtpërdrejtë në rekrutimin e gjykatësve dhe prokurorëve si dhe në emërimin e pozitive kyçe në sistemin e drejtësisë. Kjo ka ndikuar që sistemi i drejtësisë, të ketë gjykatës dhe prokurorë, sidomos në udhëheqje, që kanë lidhje të afërta apo janë “argatë” të drejtpërdrejtë të politikanëve të caktuar në pozita të larta shtetërore.

Raportet vendore dhe ndërkombëtare mbi hulumtimin e opinionit të qytetarëve rreth besueshmërisë ndaj institucioneve gjyqësore dhe prokuroriale ndër vite janë ndër më të ulëtat. Sa i përket besimit të qytetarëve për përfshirje në korrupsion, ata deklarohen se gjyqësori dhe prokuroria janë në përqindje shumë të madhe të përfshirë në korrupsion.<sup>2</sup> Mbi 25% e qytetarëve besojnë se edhe policia është e përfshirë në korrupsion.<sup>3</sup>

---

<sup>1</sup> “Raport mbi Punën e KPGJP-së”. Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial. 29 tetor 2010. Faqe 2.

<sup>2</sup> “Pulsi Publik IV”. Qershor 2018. USAID&UNDP. Sipas këtij raporti vetëm 31.2% shprehen të kënaqur me punën e gjykatave. Edhe më pak shprehen të kënaqur me punën e prokurorëve, përkatësisht vetëm 29.9%. Më shumë se gjysma e qytetarëve të anketuar, besojnë se vendimet e gjyqësorit nuk janë të pavarura, përkatësisht vetëm 43.6% besojnë se ata janë të pavarur. Sa i përket korrupsionit, qytetarët besojnë se gjyqësori në masë të madhe është i përfshirë në korrupsion. Sipas anketës, në tetor 2016 rezultoi se 49.3% e qytetarëve kanë besuar se gjyqësori ishte i përfshirë në korrupsion, në të njëjtën periudhë pas një viti (në tetor 2017) 24.9% e qytetarëve kanë besuar se gjyqësori ishin të përfshirë në korrupsion, ndërsa në prill 2018 kjo përqindje është rritur, ku 38.6% e qytetarëve besojnë se gjyqësori është i përfshirë në korrupsion.

<sup>3</sup> “Pulsi Publik IV”. Qershor 2018. USAID&UNDP. Sipas këtij raporti, për policinë, qytetarët besojnë se është më pak e përfshirë në korrupsion sesa gjyqësori. Sipas anketës, në tetor 2016 rezultoi se 21.1% e qytetarëve kanë besuar se policia ishte e përfshirë në korrupsion, në të njëjtën periudhë pas një viti (në tetor 2017) 14.9% e qytetarëve kanë besuar se policia ishin të përfshirë në korrupsion, ndërsa në prill 2018 kjo përqindje është rritur, ku 25.7% e qytetarëve besojnë se policia është e përfshirë në korrupsion.



Shteti është i kapur, ndërsa korrupsioni në Kosovë vlerësohet endemik. Këto janë konstatime të shumë prej raporteve relevante ndërkombëtare, përfshi Raportin e Progresit të Komisionit Evropian dhe Raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit.

Një prej shpjegimeve të kapjes së shtetit është politizimi i skajshëm i institucioneve publike, sidomos gjyqësorit, prokurorisë dhe policisë. Krerët e institucioneve të drejtësisë, shoqërohen me të akuzuar të profilit të lartë të politikës, duke zbehur skajshmërisht besimin e qytetarëve, se rastet e tyre trajtohen në bazë të ligjit.<sup>4</sup>

Në anën tjetër, mosndëshkimi i veprimtarive të korrupsionit, sidomos të profilit të lartë, dëshmon për amnistinë e tërësishme që iu bëhet politikanëve të korruptuar. IKD ka ngritur shqetësime për dukurinë e amnistisë së zyrtarëve të profilit të lartë, ndaj të cilëve qëllimisht ngriten aktakuza pa mbështetje të provave dhe dëshmive, të cilat rrëzohen në Gjykata, duke iu krijuar imunitet përjetësisht për të mos u ndjekur për veprat e njëjta.

Në burgjet e Kosovës, ende nuk vuan dënim me burgim efektiv asnjë zyrtar i profilit të lartë për shkak të aktgjyqimit të formës së prerë për korrupsion. Mungesa e respektimit të sundimit të ligjit, korrupsioni i nivelit të lartë dhe pasurimi i shpejtë i zyrtarëve të lartë, shkalla e madhe e papunësisë, mungesa e investimeve të huaja, besueshmëria e ulët e qytetarëve në institucione të drejtësisë, dëshmon se sistemi i drejtësisë i ndikuar skajshmërisht nga politika dhe grupet e interesit, bashkëjeton me veprimtaritë kriminale dhe korruptive, duke mos i ndjekur dhe gjykuar ato.

Pavarësisht investimeve të shumta për ta ndërtuar dhe avancuar integritetin e sistemit të drejtësisë në Kosovë, gjendja e krijuar ndër vite, mund të ndryshohet vetëm përmes vetingut, i cili duhet të përfshijë policinë, prokurorinë dhe gjyqësorin. Procesi i vetingut është thelbësor në fillimin e zbatimit të një reforme të thellë në drejtësi për shkak se një sistem i pavarur dhe i paanshëm i drejtësisë ndikon në vendosjen e sundimit të ligjit dhe shtetit të së drejtës në Kosovë. Republika e Kosovës nuk mund të synojë respektim të sundim të ligjit, pa përfshirjen e policisë, prokurorisë dhe gjyqësorit në një veting të thellë, i cili do të largonte nga sistemi policët, prokurorët dhe gjykatësit që janë të afërt me politikën, kanë shërbyer për interesa politike dhe të grupeve të interesit, kanë dëshmuar performancë të dobët gjatë ushtrimit të detyrave, kanë krijuar pasuri të pashpjegueshme etj. Një proces i thellë i vetingut, duhet të ketë konsensusin e të gjitha partive politike dhe duhet të përgatitet dhe udhëhiqet ekskluzivisht nga partnerët ndërkombëtarë si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britania e Madhe dhe Gjermania.

---

<sup>4</sup> “Takimet private të zyrtarëve të akuzuar me krerët e sistemit të drejtësisë”. Koha.net. 19 shtator 2018. (Shih linkun <https://www.koha.net/video/118115/takimet-private-te-zyrtareve-te-akuzuar-me-kreret-e-sistemit-te-drejtises/>)

## II. Integriteti i Institucioneve të Drejtësisë dhe Sigurisë

Një gjyqësor me integritet të padiskutueshëm është instituti themelor dhe i domosdoshëm për të siguruar pajtueshmërinë në mes të demokracisë dhe sundimin të ligjit. Edhe kur të gjitha mbrojtjet e tjera dështojnë, sistemi gjyqësor me integritet është garancia kryesore kundër çdo shkelje apo keqpërdorimi të të drejtave dhe lirive. Për të siguruar gjyqësor me integritet duhet përkushtim dhe është një detyrë në të cilën duhet investuar shumë energji, aftësi dhe përvojë.<sup>5</sup>

Parimet e Bangallorit lidhur me sjelljen gjyqësore kanë përcaktuar vlerat mbi të cilat duhet të bazohet një gjyqësor i pavarur, i paanshëm dhe i drejtë. Një ndër parimet e Bangallorit të sjelljes gjyqësore është integriteti i gjyqësorit. Integriteti është atribut i ndershmërisë dhe drejtësisë, pra komponentë kryesor janë ndershmëria dhe morali gjyqësor. Gjyqtari gjatë gjithë kohës duhet të veprojë me ndershmëri, jo vetëm gjatë kryerjes së detyrave zyrtare dhe në mënyrën që i përshtatet profesionit gjyqësor. Ai duhet të ketë virtyte të mira, sjellje të mirë dhe të përçojë siguri tek publiku. Këtu integriteti është absolut. Në gjyqësi, integriteti është më shumë se një virtyt, integriteti është domosdoshmëri.<sup>6</sup>

Përderisa standardet dhe parimet ndërkombëtare, integritetit si vlerë, i japin kuptimin e gjendjes të bazuar në parime morale të drejtësisë dhe ndershmërisë, tek institucionet kosovare dhe individë të caktuar që udhëheqin me institucionet kryesore të sistemit të drejtësisë, fatkeqësisht opinioni publik vazhdon t'i kuptojë si sinonim të dukurive negative si: “korrupsioni”, “nepotizmi” “kërcënimi” apo “kundërligjshmëria”.

Edhe pse bashkësia ndërkombëtare në bashkëpunim edhe me shoqërinë civile që nga paslufta kanë investuar në shumë aspekte që sektori i drejtësisë dhe sigurisë të rrisë nivelin e integritetit të institucioneve të drejtësisë, fatkeqësisht realiteti është krejt tjetër. Sistemi i drejtësisë në Kosovë ende nuk është në gjendje të pranojë dhe të zbatojë në praktikë vlerat që lidhen me integritetin si ndershmëri dhe drejtësi.

Shtetet si Kosova, të cilat kalojnë përmes fazës së tranzicionit të shtet – ndërtimit, do të duhej të krijonin një sistem më të sigurt dhe të besueshëm. Në Kosovë, praktika ka treguar se realisht pasiguria juridike është shndërruar në standard, zbatimi i ligjit nuk zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjithë qytetarët dhe kjo po ndikon që besimi i publikut në institucionet e drejtësisë të jetë në nivelin më të ulët të mundshëm. Kjo konfirmohet nga hulumtimet vendore dhe ndërkombëtare të realizuara mbi besueshmërinë e qytetarëve në sistemin e drejtësisë.

Dështimet e vazhdueshme në sektorin e drejtësisë dhe sigurisë kanë krijuar pasiguri juridike dhe fizike për qytetarët por edhe për zyrtarët e ndershëm që ushtrojnë funksione në institucionet e Republikës së Kosovës, të cilët persekutohen në rrugë ligjore, duke përdorur politika dhe grupet e interesit sistemin e drejtësisë dhe sigurisë për interesa personale. Kjo ka ulur në masë të madhe nivelin e integritetit të sistemit të drejtësisë dhe sigurisë në Kosovë, duke shndërruar këto institucione në mekanizma të pabesueshëm për të ofruar siguri dhe drejtësi.

<sup>5</sup> C.G. Weeramantry, Kryesues i Grupit për Integritet Gjyqësor.

<sup>6</sup> Parimet e Bangallorit (lidhur me sjelljen gjyqësore)

### III. Kapja e institucioneve të drejtësisë dhe sigurisë – analizë e rasteve konkrete

Organizatave e shoqërisë civile, që monitorojnë sistemin e drejtësisë në Kosovë, kanë identifikuar, hulumtuar dhe analizuar raste dhe fenomene të cilat kanë ndodhur viteve të fundit në Kosovë, duke radhitur një numër të madh të rasteve, të cilat dëshmojnë dështimet e institucioneve të drejtësisë dhe sigurisë në zbatimin e obligimeve kushtetuese dhe ligjore në mbrojtje të parimeve të sundimit të ligjit, rrjedhimisht duke dëshmuar nivelin e ulët të integritetit të individëve në këto institucione të drejtësisë dhe sigurisë.

Publiku në Kosovë, media, OJQ-të, qytetarët, shërbyesit civil, administrata shtetërore në ato raste kur ballafaqohen me dukuritë e korrupsionit në Kosovë nuk kanë një adresë të besueshme për të raportuar të njëjtat. Instalimi i kulturës së pandëshkueshmërisë ka rritur mungesën e besimit që këto dukuri t'i raportojnë tek institucionet kompetente që këto raste t'i trajtojnë në mënyrë të pavarur, paanshme dhe profesionalisht.<sup>7</sup>

Në vazhdim do të prezantohen disa prej rasteve që janë vlerësuar si më reprezentative në aspektin e dështimeve, të cilat dëshmojnë integritetin e individëve në institucionet e drejtësisë dhe sigurisë, të cilët duhet të mbahen përgjegjës dhe të largohen nga sistemi përfundimisht.

Padyshim se një prej rasteve më skandaloze, i cili ka shpërfaqur ndërhyrjet dhe ndikimet nga jashtë dhe brenda sistemit të drejtësisë është rasti i prokurorit special Elez Blakaj. Ky rast, dëshmon për ndërhyrjet politike dhe të pushtetit ekzekutiv nga jashtë si dhe ndërhyrjet nga brenda të Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi në trajtimin e rastit të veteranëve si dhe rastit të aferës së përgjimeve “Pronto”.

---

<sup>7</sup> “Ndërhyrjet politike në sistemin e politizuar prokurorial, alarm për nevojën e vetingut në polici, prokurori dhe gjykata”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. 30 gusht 2018. (Shih linkun <http://kli-ks.org/nderhyrjet-politike-ne-sistemin-e-politizuar-prokurorial-alarm-per-nevojen-e-vetingut-ne-polici-prokurori-dhe-gjykata/>)

## 1) Rasti Blakaj: Ndërhyrjet politike dhe të Kryeprokurorit në rastin e veteranëve dhe prontos

Prokurori i Shtetit, sipas Kushtetutës ka përgjegjësi ligjore për ndjekjen e personave që dyshohen se kanë kryer vepra penale. Ky është organi që ka mandatin kryesor në luftimin e kriminalitetit, në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe të drejtë.<sup>8</sup>

Elez Blakaj, prokuror në PSRK, më 13 gusht 2018 kishte ofruar dorëheqje nga pozita.<sup>9</sup> Ndërsa, më 16 gusht 2018, përmes një letre të postuar në rrjetin social “Facebook”, kishte informuar opinionin publik se më 11 korrik 2018, kishte dorëzuar aktakuzën për rastin e njohur si “Veteranët”, në zyrën e Kryeprokurorit të PSRK-së, Reshat Millaku.<sup>10</sup>

Pas letrës së parë, pati reagime të shumta, nga të cilat edhe akuza kundrejt personalitetit dhe profesionalizmit të prokurorit Blakaj, të cilat e shtynë atë që të paraqesë edhe një letër tjetër, më 20 gusht 2018, duke u paraqitur edhe në rolin e sinjalizuesit. Prokurori Blakaj, kësaj radhe, në publik paraqiti kërcënimet dhe presionet që kishte pasur që nga koha kur kishte filluar trajtimin e rastit të “Veteranëve”.<sup>11</sup>

Blakaj, në një intervistë për “Betimi për Drejtësi”, kishte deklaruar se në çdo hetim të profilit të lartë, Kryeprokurori Aleksandër Lumezi, kërkonte sqarime, madje edhe kur personat e profilit të lartë ftoheshin thjesht në cilësi të dëshmitarëve.<sup>12</sup> Dorëheqja e Blakajt dhe arsyet e kësaj dorëheqjeje shkaktuan reagime të shumta në publik, përfshirë reagime nga shoqëria civile, institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare.

IKD kishte konsideruar se dorëheqja e prokurorit Blakaj, e tregonte gjendjen e sigurisë dhe të funksionimit të sistemit prokurorial, në të cilin ndikojnë politika dhe grupet e interesit, që pamundësojnë hetime të pavarura.<sup>13</sup>

Ambasada Amerikane në Kosovë, e kishte vlerësuar si dekurajuese dorëheqjen e Blakajt.<sup>14</sup> Ambasadori Amerikan në Kosovë, Greg Delawie, e kishte quajtur të trishtë ditën kur prokurori

<sup>8</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Neni 109.

<sup>9</sup> “Për shkak të kërcënimeve jep dorëheqje prokurori special, Elez Blakaj”. Koha.net. 15 gusht 2018. (Shih linkun <https://www.koha.net/arberi/111200/per-shkak-te-kercenimeve-jep-doreheqje-prokurori-special-elez-blakaj/>)

<sup>10</sup> “Prokurori special Elez Blakaj, në dorëheqjen e tij, konfirmon se nga 11 korriku aktakuzën e ngritur ia ka dorëzuar Kryeprokurorit special, Reshat Millaku”. Betimi për Drejtësi. 16 gusht 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurori-special-elez-blakaj-ne-doreheqjen-e-tij-konfirmon-se-nga-11-korriku-aktakuzen-e-ngritur-ia-ka-dorezuar-kryeprokurorit-special-reshat-millaku/>)

<sup>11</sup> “Flet Elez Blakaj, thotë se kishte kërcënime nga veteranët, përmend presionin e Kryeprokurori Aleksandër Lumezi për veteranët e UÇK-së dhe rastin “Pronto”. Betimi për Drejtësi. 20 gusht 2018. <https://betimiperdrejtesi.com/flet-elez-blakaj-thote-se-kishte-kercenime-nga-veteranet-permend-presionin-e-kryeprokurori-aleksander-lumezi-per-veteranet-e-uck-se-dhe-rastin-pronto/>

<sup>12</sup> “Çfarë thotë Blakaj për kërcënimet nga Kryeprokurori Lumezi, Kryeministri Haradinaj dhe të tjerët? (Video)”. Betimi për Drejtësi. 12 shtator 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/cfare-thote-blakaj-per-kercenimet-nga-kryeprokurori-lumezi-kryeministri-haradinaj-dhe-te-tjere-video/>)

<sup>13</sup> “Ndërhyrjet politike në sistemin e politizuar prokurorial, alarm për nevojën e vetingut në polici, prokurori dhe gjykata”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. 30 gusht 2018. (Shih linkun <http://kli-ks.org/nderhyrjet-politike-ne-sistemin-e-politizuar-prokurorial-alarm-per-nevojen-e-vetingut-ne-polici-prokurori-dhe-gjykata/>)Faqe 4.

Blakaj kishte dhënë dorëheqje.<sup>15</sup> Njëkohësisht, Delawie, në një ligjëratë para studentëve të Fakultetit Juridik, kishte thënë se në rastin e “Veteranëve”, të cilin e kishte hetuar Blakaj, kishte pasur kërcënime si nga brenda sistemit të drejtësisë, ashtu edhe jashtë tij.<sup>16</sup>

Edhe Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, kishte shprehur shqetësimin e saj për ndërhyrjet në sistemin e drejtësisë pas dorëheqjes së Blakajt. “Deklaratat e disa politikanëve dhe prokurorëve në Kosovë rrezikojnë parimet kryesore të sundimit të ligjit. Për më tepër, ato dërgojnë sinjale dekurajuese tek të gjithë zyrtarët ligjorë që trajtojnë lëndë të ndjeshme dhe të rëndësishme”.<sup>17</sup>

KPK më 22 gusht 2018, përmes një komunikate për media kishte thënë se ky institucion është duke u angazhuar që Prokurori i Shtetit të veprojë si i pavarur dhe i paanshëm. Në këtë komunikatë KPK, edhe pse i thirrur për të mbrojtur dhe siguruar pavarësinë e sistemit prokurorial, kishte thënë po ashtu se ky organ nuk do të ketë kompromise për asnjë prokuror në rast të dështimit të kryerjes së detyrave të tyre.<sup>18</sup>

Shoqata e prokurorëve, e udhëhequr nga Kryeprokurori i Prokurorisë së Apelit, Haxhi Dërguti, e cila është e thirrur që të mbrojë interesat e prokurorëve, nuk i doli në mbrojtje prokurorit Blakaj, përkundrazi. “Deri më tani, asnjë prokuror i sistemit prokurorial të Kosovës, duke përfshirë dhe ish – prokurorin Blakaj, nuk ka shprehur asnjë shqetësim, qoftë si kërcënim apo si ndikim në punën e tij të pavarur dhe të paanshme nga kushdo qoftë. Andaj, deklaratimet publike për kinse kërcënime dhe ndikime brenda sistemit prokurorial, janë për të mbuluar interesat e tij personale apo të kujtdo tjetër”, thuhej në këtë reagim.<sup>19</sup>

Edhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, kishte theksuar se kjo Zyrë, asnjëherë nuk kishte marrë informacione se prokurori Blakaj, ishte kërcënuar ndonjëherë lidhur me rastin e “Veteranëve”.<sup>20</sup>

Për më tepër, Kryeprokurori i Shtetit Aleksandër Lumezi, në një intervistë për portalin “Gazeta Express”, e kishte quajtur Blakajn, prokuror joprofesional, frikacak, të dështuar dhe prokuror të

---

<sup>14</sup> “Ambasada amerikane për dorëheqjen e Prokurorit Special: Rast shumë dekurajues”. KlanKosova.tv. 15 gusht 2018. (Shih linkun <http://klankosova.tv/ambasada-amerikane-per-doreheqjen-e-prokurorit-special-rast-shume-dekurajues/>)

<sup>15</sup> Reagimi i Ambasadorit Amerikan Greg Delawie në rrjetin social Facebook. 15 gusht 2018. (Shih linkun <https://www.facebook.com/kosovo.usembassy/posts/2663396183686520>)

<sup>16</sup> “Ambasadori amerikan thotë se UÇK-ja s’kishte më shumë se 15 mijë ushtarë, thotë se pati presion dhe frikësim ndaj prokurorit Blakaj”. Betimi për Drejtësi. 31 gusht 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ambasadori-amerikan-thote-se-uck-ja-skishte-me-shume-se-15-mije-ushtare-thote-se-pati-presion-dhe-frikesim-ndaj-prokurorit-blakaj/>)

<sup>17</sup> Reagimi i Zyrës së BE-së në Prishtinë për rastin Blakaj. 22 gusht 2018. (Shih linkun <https://www.facebook.com/610960288923231/posts/statement-by-the-eu-office-in-kosovoeu-special-representativethe-eu-is-closely-f/2059258884093357/>)

<sup>18</sup> “KPK e diskuton me dyer të mbyllura dorëheqjen e ish-prokurorit të PSRK-së, Elez Blakaj”. Betimi për Drejtësi. 7 shtator 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kpk-e-diskuton-me-dyer-te-mbyllura-doreheqjen-e-ish-prokurorit-te-psrk-se-elez-blakaj/>)

<sup>19</sup> “Shoqata e Prokurorëve: Blakaj s’ka shprehur asnjë kërcënim”. Evropaelire.org. 23 gusht 2018. (Shih linkun <https://www.evropaelire.org/a/29449560.html>)

<sup>20</sup> “Kryeprokurori i Shtetit tregon për kërcënimet ndaj prokurorit të dorëhequr, Elez Blakaj”. Koha.net. 15 gusht 2018. (Shih linkun <https://www.koha.net/arberi/111282/kryeprokurori-i-shtetit-tregon-per-kercenimet-ndaj-prokurorit-te-dorehequr-elez-blakaj/>)

profileve të ulëta.<sup>21</sup> Deklarata e tillë, e Kryeprokurorit Lumezi, ishte kontradiktore, për faktin se disa ditë më herët i njëjti kishte dhënë vlerësime pozitive për Prokurorin Blakaj, duke thënë se ai “nuk është tërhequr për shkak të kanosjes, sepse ka qenë prokuror i vendosur dhe i pa korruptuar dhe i guximshëm.”<sup>22</sup> Pra, pasi Blakaj tregoi arsyet e dorëheqjes, ndryshoi edhe qëndrimi i Lumezit.

Gjuhë ofenduese përdori edhe Kryeministri i Kosovës Ramush Haradinaj. Ai në një intervistë për emisionin “Interaktiv”, ish-Prokurorin Blakaj, e ka quajtur “hajn të pulave dhe pishpirik”. Po ashtu, kishte thënë se “një i ikur në Bllacë e Stankovec, nuk mund të vlerësojë numrin e saktë të veteranëve”, për të cilin Blakaj, kishte zhvilluar hetime intensive për disa muaj.<sup>23</sup>

Në intervistën e Blakajt dhënë për “Betimi për Drejtësi”, përpos tjerash, ai kishte thënë se mënyra e bashkëpunimit të Haradinajt me prokurorinë ka qenë e papranueshme, pasi sipas tij, kërkesa që prokurori t’i raportojë kryeministrit lidhur me hetimet, është në kundërshtim me rregullimin kushtetues të Kosovës, që bën ndarjen e pushteteve.<sup>24</sup>

Fryma e kërcënimeve ndaj Blakajt kishte shkuar shumë larg. Kështu, deputeti i AAK-së, Shkumbin Demalijaj, në një intervistë në televizion publik RTK, e kishte quajtur Blakajn “kriminel”, “dezertor”, “hajn”, “idiot” e “rrugaç”. Ai kishte thënë se nëse shteti nuk e ndjek Blakajn në Kosovë për ta gjykuar, sipas tij për “shantazhin” që i ka bërë opinionit, atëherë ai do ta ndjek privatisht.<sup>25</sup>

Edhe përkundër deklaratave të tilla, Prokurori i Shtetit nuk e kishte parë të arsyeshme t’i hetojë akuzat publike të deputetit Demalijaj ndaj prokurorit Blakaj. Vetëm pas reagimit të shoqërisë civile dhe me 11 ditë vonesë, Prokuroria Themelore në Prishtinë kishte vendosur të reagojë. Sipas kërkesës së kësaj prokurorie, pas seancës dëgjimore të 28 shtatorit 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë i kishte caktuar 30 ditë paraburgim Demalijajt.<sup>26</sup> Pas ankesës ndaj këtij vendimi, Gjykata e Apelit, më 4 tetor 2018, masën e paraburgimit ia kishte zëvendësuar me

---

<sup>21</sup> “Ekskluzive, flet Aleksandër Lumezi: Elez Blakaj është frikacak, prokuror i dështuar dhe joprofesional”. Gazetaexpress.com. 20 gusht 2018. (Shih linkun <https://www.gazetaexpress.com/lajme/ekskluzive-flet-aleksander-lumezi-elez-blakaj-eshte-frikacak-prokuror-i-deshtuar-dhe-joprofesional-568679/?archive=1> )

<sup>22</sup> “Ende pa nisur hetimet, Lumezi thotë se Blakaj nuk iku nga kërcënimet”. Gazetaexpress.com. 16 gusht 2018. (Shih linkun <https://www.gazetaexpress.com/lajme/ende-pa-nisur-hetimet-lumezi-thote-se-blakaj-nuk-iku-nga-kercenimet-567639/?archive=1> )

<sup>23</sup> “Haradinaj e quan Blakajn hajn e pishpirik - “s’ mund të vlerësojë veteranët i ikuri në Bllacë”. Koha.net. 21 gusht 2018. (Shih linkun <https://www.koha.net/video/112385/haradinaj-e-quan-blakajn-hajn-e-pishpirik-smund-te-vleresoje-veteranet-i-ikuri-ne-bllace/> )

<sup>24</sup> “Si ndërhyri Kryeministri Haradinaj në hetimet e prokurorit Elez Blakaj? (Video)”. Betimi për Drejtësi. 12 shtator 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/si-nderhyri-kryeministri-haradinaj-ne-hetimet-e-prokurorit-elez-blakaj-video/> )

<sup>25</sup> “Demalijaj kërcënon Elez Blakajn: Ai është dezertor, hajn, idiot, rrugaç..., do të merrem privatisht me të”. Telegrafi.com. 17 shtator 2018. (Shih linkun <https://telegrafi.com/demalijaj-sulmon-rende-elez-blakajn-ai-eshte-dezertor-hajn-idiot-rrugac-do-te-merrem-privatisht-me-te/> )

<sup>26</sup> “Një muaj paraburgim edhe ndaj deputetit Shkumbin Demalijaj”. Betimi për Drejtësi. 28 shtator 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/nje-muaj-paraburgim-edhe-ndaj-deputetit-shkumbin-demalijaj/> )

arrest shtëpiak.<sup>27</sup> Aktakuza e veteranëve më pas është ngritur edhe formalisht në Gjykatë nga Prokurori Special Afrim Shefkiu.

## 2) Deportimi i gjashtë shtetasve turq nga Kosova

Një prej rasteve, i cili ka ngjallur debat publik jo vetëm në nivel vendi por edhe mekanizmat ndërkombëtar, është deportimi i gjashtë shtetasve turq nga Kosova. Ky rast, për të cilin janë iniciuar dhe ende po vazhdojnë hetimet parlamentare për përgjegjësinë e zyrtarëve të lartë shtetërorë dhe institucioneve të drejtësisë, sigurisë dhe inteligjencës është vlerësuar skandaloz për shkak të deportimit, i cili ka ndikuar në shkeljen e të drejtave dhe lirive të njeriut, duke kontestuar në thelb elementet e shtetit ligjor të Republikës së Kosovës.

Më 29 mars 2018, në Kosovë, ishin arrestuar dhe deportuar gjashtë shtetasit turq, Cihan Ozkan, Kahraman Demirez, Hasan Husein Günakan, Mustafa Erdem, Osman Karakaya dhe Yusuf Karabina, të cilët nga autoritetet turke dyshohen se janë pjesëtar të organizatës “FETO” të Fetullah Gulen, i cili akuzohet se kishte organizuar puçin e vitit 2016 në Turqi, kundër qeverisë së Recep Tayyip Erdogan. Këta u deportuan nga Kosova, edhe përkundër faktit se të njëjtit kishin leje qëndrimi valide, të lëshuara nga Republika e Kosovës, mirëpo më vonë, MPB-ja kishte revokuar lejet e qëndrimit për shtetasit e arrestuar të Turqisë.<sup>28</sup>

Lidhur me deportimin e shtetasve turq përveç organizatave jo-qeveritare në Kosovë që e kishin kritikuar dhe dënuar qasjen dhe mënyrën e trajtimit të këtij rasti nga institucionet vendore, kishte reagim edhe nga organizatat më me renome në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Sipas “Amnesty International”, burgjet turke nuk janë të sigurta, veçanërisht për gulenistët e akuzuar. Në raportin e “Human Rights Watch”, thuhej se “tortura dhe keqtrajtimi nën kontrollin e policisë në Turqi është shndërruar në një problem mjaft të përhapur”.<sup>29</sup> Kjo organizatë deklaroi se arrestimi i shtetasve turq në Kosovë ka treguar një mospërfillje të heshtur për të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit. Përveç arrestimit të dyshimtë, gjashtë personat janë dërguar në një shtet ku përballen me rrezik serioz të torturës. Presidenti i Kosovës, kryeministri dhe kryetari i parlamentit, të cilët deklarojnë se nuk kishin njohuri mbi këtë operacion, duhet të kërkojnë një hetim të plotë dhe të shpjegojnë se si ndodhi e gjithë kjo.<sup>30</sup>

---

<sup>27</sup> “Deputeti Shkumbin Demalijaj lirohet nga paraburgimi, i caktohet masa e arrestit shtëpiak”. Betimi për Drejtësi. 4 tetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deputeti-shkumbin-demalijaj-lirohet-nga-paraburgimi-i-caktohet-masa-e-arrestit-shtepiak/>)

<sup>28</sup> “Turqit e deportuar kishin leje qëndrimi (DOKUMENT)”. KlanKosova.tv. 29 mars 2018. (Shih linkun <http://klankosova.tv/turqit-e-ekstraduar-kishin-leje-qendrimi-dokument/>)

<sup>29</sup> “Turkey’s Puppet”: How Erdogan’s Anti-Gulenist Campaign Is Roiling Kosovo”. Pulitzercenter.org. 12 shtator 2018. (Shih linkun <https://pulitzercenter.org/reporting/turkeys-puppet-hoë-erdogans-anti-gulenist-campaign-roiling-kosovo>)

<sup>30</sup> “Human Rights Watch: Arrest of Turkish nationals in Kosovo a callous disregard for Human Rights”. 30 mars 2018. (Shih linkun <https://turkeypurge.com/human-rights-watch-arrest-turkish-nationals-kosovo-callous-disregard-human-rights>)



Pati reagime edhe nga përfaqësues të BE-së, të Ambasadës Amerikane në Kosovë dhe të institucioneve të tjera vendore dhe ndërkombëtare.

Bashkimi Evropian përmes një komunikate pati deklaruar se “arrestimi dhe deportimi i gjashtë shtetasve, që kanë jetuar ligjërisht në Kosovë, ngritë pyetje për respektimin e procesit të rregullt gjyqësor”.<sup>31</sup> “Sundimi i ligjit është parim themelor i Bashkimit Evropian. Në përputhje me vendosmërinë për të ndërtuar një të ardhme të lirë dhe demokratike, siç edhe përcaktohet me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, të gjitha veprimet e institucioneve lokale të Kosovës janë të lidhura me respektimin e sundimit të ligjit dhe promovimit të të drejtave universale dhe lirive themelore të njeriut. Procedurat arbitrare lidhur me arrestimin, ndalimin apo azilin janë kundër këtyre parimeve”, është thënë në deklaratë.<sup>32</sup>

“Duke ndjekur nga afër ngjarjet e djeshme. Transparenca dhe angazhimi në procesin e duhur dhe sundimi i ligjit janë jetike”, kishe shkruar ambasadori amerikan Greg Delawie në reagimin e tij, përmes rrjetit social “Twitter”.<sup>33</sup>

Reagime ka pasur edhe nga institucioni i Avokatit të Popullit, përmes një njoftimi të lëshuar për media. “Kjo konsiderohet si një prej shkeljeve më të rënda që ka të bëjë me mbrojtjen nga keqtrajtimi, turpërimi, trajtimi çnjerëzor dhe degradues që është neni 3 i Konventës Evropiane. Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj, saktëson qartë garancitë procedurale në lidhje me dëbimin e të huajve. Në kuptim të nenit 3, nenit 6, nenit 8 dhe nenit 13 të KEDNJ-së, ashtu siç edhe Parimit themelor të mos-kthimit, sipas Konventës për Refugjatë të vitit 1951, përgjegjësia bie tek autoritetet shtetërore kompetente lidhur me situatën e krijuar”, thuhej në një njoftim të Avokatit të Popullit.<sup>34</sup>

Për këtë çështje, kanë reaguar edhe familjet e shtetasve turq të deportuar. Ata përveç deklaratave të dhëna, së fundi kanë reaguar edhe në rrugë zyrtare. Familjet e gjashtë shtetasve turq kanë ngritur padi ndaj Qeverisë së Kosovës, si dhe janë duke përgatitur dosjet për iniciimin e procedurave të tjera penale. Lajmin e ka konfirmuar Urim Vokshi, avokati i njëres prej gjashtë familjeve të shtetasve turq të dëbuar nga Kosova.<sup>35</sup>

---

<sup>31</sup> “Reagon BE: Deportimi i turqve vë në pikëpyetje respektimin e procesit ligjor”. Telegrafi.com. 3 prill 2018. (Shih linkun <https://telegrafi.com/reagon-deportimi-turqve-ve-ne-pikepyetje-respektimin-e-procesit-ligjor/>)

<sup>32</sup> Po aty

<sup>33</sup> “U.S. AMBASSADOR COMMENTS ON ARREST OF TURKISH NATIONALS”. Rtklive.com. 30 mars 2018. (Shih linkun <https://www.rtklive.com/en/news-single.php?ID=11197>)

<sup>34</sup> “Kosovë: Parlamenti heton deportimin e gjashtë shtetasve turq”. Dw.com. 5 prill 2018. (Shih linkun <https://www.dw.com/sq/kosov%C3%AB-parlamenti-heton-deportimin-e-gjasht%C3%AB-shtetasve-turq/a-43267347>)

<sup>35</sup> “Ngritet padi ndaj përgjegjësve për dëbimin e shtetasve turq”. Telegrafi.com. 7 prill 2018. (Shih linkun <https://telegrafi.com/ngritet-padi-ndaj-pergjegjesve-per-debimin-e-shtetasve-turq/>)

Në anën tjetër, me një vendim të marrë kohën e fundit, Gjykata Themelore e Prishtinës i ka shpallur të parrezikshëm për vendin dy nga gjashtë shtetasit turq, të arrestuar dhe deportuar më 29 mars të këtij viti.<sup>36</sup>

Ndërsa, më 4 prill 2018, Kuvendi i Kosovës ka miratuar rezolutën, për formimin e Komisionit Hetimor, i cili do të merret me hetimin e çështjes së deportimit të gjashtë shtetasve turq nga Kosova. Ky Komision ka filluar me intervistimin e të gjithë personave të cilët konsiderohen përgjegjës lidhur me këtë çështje.

Deri më tani janë intervistuar zyrtarë të Inspektoratit Policor të Kosovës, konkretisht kryeshefja Miradije Kelmendi, bashkë më ekipin e saj<sup>37</sup>, zyrtarë policorë të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”<sup>38</sup>, Shpend Maxhuni, i cili në kohën e deportimit të 6 shtetasve turq ka qenë drejtor i përgjithshëm i Policisë së Kosovës<sup>39</sup>, ministri i Infrastrukturës Pal Lekaj<sup>40</sup>, Ismail Berisha, ish–drejtor i Departamentit të Aviacionit Civil, si dhe Bahri Nuredini, drejtor i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror.<sup>41</sup> Ndërsa, në mbledhjen 26 nëntorit 2018, Komisioni Hetimor kishte në rend dite intervistimin e presidentit Hashim Thaçi, kryeministrit Ramush Haradinaj dhe sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Lulzim Ejupi, megjithatë asnjë nga këto intervistime ende nuk kanë ndodhur.<sup>42</sup> Ndërsa, më 30 nëntor 2018, Komisioni Hetimor intervistoi kryeministrin e vendit Ramush Haradinaj, i cili tha se dëbimi i shtetasve turq ka qenë një mënyrë e nxituar, sepse ka mundur të shkojë ndryshe nëpër etapa që i parasheh ligji, si dhe çështja tjetër është se ai nuk ka qenë i informuar për këtë.<sup>43</sup> Lidhur me mos informimit e tij, siç parasheh ligji për këto ngjarje, ai tha se kishte kërkuar

---

<sup>36</sup> “Gjykata vendos se disa prej turqve të dëbuar nuk përbënin rrezik për Kosovën”. Koha.net. 14 nëntor 2018. (Shih linkun <https://www.koha.net/arberi/128931/gjykata-vendos-se-disa-prej-turqve-te-debuar-nuk-perbenin-rrezik-per-kosoven/>)

<sup>37</sup> “Për dëbimin e shtetasve turq po intervistohen zyrtarë të lartë shtetërorë”. Telegrafi.com. 18 tetor 2018. (Shih linkun <https://telegrafi.com/per-debimin-e-shtetasve-turq-po-intervistohen-zyrtare-te-larte-shtetorore/>)

<sup>38</sup> “Intervistohen policët e Aeroportit për deportimin e ‘gülenistëve’”. Telegrafi.com. 29 tetor 2018. (Shih linkun <https://telegrafi.com/intervistohen-policet-e-aeroportit-per-deportimin-e-gylenisteve/>)

<sup>39</sup> “Edhe Shpend Maxhuni do të intervistohet rreth deportimit të gülenistëve”. Telegrafi.com. 29 tetor 2018. (Shih linkun <https://telegrafi.com/edhe-shpend-maxhuni-te-intervistohet-rreth-deportimit-te-gylenisteve/>)

<sup>40</sup> “Lekaj intervistohet për dëbimin e shtetasve turq, thotë se kompania turke keqpërdori lejen e fluturimit”. Telegrafi.com. 21 nëntor 2018. (Shih linkun <https://telegrafi.com/lekaj-intervistohet-per-debimin-e-shtetasve-turq-thote-se-kompania-turke-keqperdori-lejen-e-fluturimit/>)

<sup>41</sup> “Deportimi i shtetasve turq, Berisha: Nuk kemi qenë të informuar për natyrën e fluturimit”. Telegrafi.com. 21 nëntor 2018. (Shih linkun <https://telegrafi.com/deportimi-shtetasve-turq-berisha-nuk-kemi-qene-te-informuar-per-natyren-e-fluturimit/>)

<sup>42</sup> “Komisioni hetimor për dëbimin e turqve mban mbledhje, në rend dite intervistimi i krerëve shtetërorë”. Telegrafi.com. 26 nëntor 2018. (Shih linkun <https://telegrafi.com/komisioni-hetimor-per-debimin-e-turqve-mban-mbledhje-ne-rend-dite-intervistimi-krereve-shtetorore/>)

<sup>43</sup> “Dëbimi i gjashtë shtetasve turq nga Kosova, Haradinaj tregon në detaje ngjarjet e asaj dite”. Telegrafi.com. 30 nëntor 2018. (Shih linkun <https://telegrafi.com/debimi-gjashte-shtetasve-turq-nga-kosova-haradinaj-tregon-ne-detaje-ngjarjet-e-asaj-dite/>)

shkarkimin e drejtorit të AKI-së, Driton Gashi, si dhe ministrit të Punëve të Brendshme, Flamur Sefajt.<sup>44</sup>

Në anën tjetër, kryetari i këtij komisioni, deputeti Xhelal Sveçla, ka bërë të ditur se deri më tash kanë gjetur mangësi dhe kanë identifikuar shkelje ligjore.<sup>45</sup> Ai tha se po synojnë të identifikojnë përgjegjësit kryesor në këtë rast. Sipas tij, deri tani ende nuk kanë qartësi se nga ka ardhur urdhri për deportim të gjashtë shtetasve turq, por tha se beson se do të shkojnë drejt identifikimit.<sup>46</sup>

### 3) Vendimi i Qeverisë për rritjen e pagave dhe zvarritja e hetimeve nga prokuroria

Në mbledhjen e 20 dhjetorit 2017, Qeveria e Republikës së Kosovës kishte marrë vendim për rritjen e pagave. Vendimi Nr. 4/20 i Qeverisë, lidhej me ngritjen e mirëqenies ekonomike të një kategorie të pozitive të kabinetit qeveritar, përfshirë ngritjen e pagës së Kryeministrit, zëvendës-kryeministrave, ministrave, këshilltarëve, dhe një kategorie të shërbyesve civilë. Përmes këtij vendimi, pothuajse janë dyfishuar pagat e pozitive të lartpërmendura.

Ky vendim tejkalon kompetencat e përcaktuara me Ligj dhe me Rregulloren e Punës së Qeverisë, e cila në asnjë dispozitë të saj nuk përcakton kompetencat dhe përgjegjësitë e Qeverisë për caktimin e pagave apo kompensimit për Kryeministrin apo ministrat.<sup>47</sup>

Në bazë të Kushtetutës dhe ligjit të aplikueshëm në Kosovë, kompetente për të vendosur lidhur me pagat e funksionarëve të lartë publik në Kosovë, veçanërisht për pozitën e Kryeministrit dhe ministrave është Kuvendi i Kosovës. Prandaj, ky vendim është i kundërligjshëm dhe ndërhyrje arbitrare e drejtpërdrejtë në kompetencat e Kuvendit të Kosovës.<sup>48</sup>

Më 29 janar 2018, Agjencia Kundër Korrupsionit, në opinionin e saj, e kishte konsideruar të jashtëligjshëm Vendimin Nr. 4/20 të Qeverisë së Republikës së Kosovës. “Prandaj, përmes këtij Opinioni, AKK rekomandon që Vendimi të kthehet në rishqyrtim, duke shfrytëzuar mënyra tjera ligjore të cilat nuk bien ndesh me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe legjislacionin tjetër relevant në fuqi”.<sup>49</sup>

Përveç që rriti pagat kundërligjshëm, Qeveria nuk e respektoi as opinionin ligjor të Agjencisë Kundër Korrupsionit. Në po të njëjtën ditë, më 29 janar 2018, tridhjetë deputetë të Kuvendit të Kosovës kanë kërkuar nga Gjykata Kushtetuese vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të

<sup>44</sup> “Haradinaj: Për deportimin e turqve u informova me vonesë”. Telegrafi.com. 30 nëntor 2018. (Shih linkun <https://telegrafi.com/haradinaj-per-deportimin-e-turqve-u-informova-vonese/>)

<sup>45</sup> “Komisioni hetimor evidenton shkelje ligjore në deportimin e gjashtë shtetasve turq”. Telegrafi.com. 12 nëntor 2018. (Shih linkun <https://telegrafi.com/komisioni-hetimor-evidenton-shkelje-ligjore-ne-deportimin-e-gjashte-shtetasve-turq/>)

<sup>46</sup> “Sveçla: Ende nuk është e qartë se nga ka ardhur urdhri për deportim të gjashtë shtetasve turq”. Telegrafi.com. 15 nëntor 2018. (Shih linkun <https://telegrafi.com/svecla-ende-nuk-eshte-e-qarte-se-nga-ka-ardhur-urdhri-per-deportim-te-gjashte-shtetasve-turq/>)

<sup>47</sup> “Loja e kundërligjshme të Kryeministrit me pagat”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. (Shih linkun <http://kiks.org/loja-e-kunderligjshme-e-kryeministrit-me-pagat/>)

<sup>48</sup> Po aty

<sup>49</sup> Po aty

qeverisë për rritjen e pagave. “Vendimin e kundërligjshëm dhe të padrejtë për rritjen e pagave, në emër të deputetëve të grupit tonë parlamentar si dhe me mbështetjen e tre deputetëve tjerë të opozitës, sot e kam dërguar edhe në Gjykatën Kushtetuese”, kishte shkruar deputetja Albulena Haxhiu, në rrjetin social “Facebook”.<sup>50</sup>

Ndërsa, më 31 janar 2018, kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, përkohësisht ishte tërhequr nga vendimi për rritjen e pagave për kabinetin qeveritar. “Vendimin e AKK – së, lidhur me nivelizimin e pagave, e vlerësoj të paqëndrueshëm dhe të ndikuar politikisht. Për këtë vendim kemi dorëzuar përgjigje të qartë dhe kjo është e njohur për opinionin. Megjithatë, pas kërkesës së 30 deputetëve të Kuvendit të Kosovës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit për nivelizim të pagave, të marrë më 20 dhjetor nga Qeveria e Kosovës, kam vendosur që përkohësisht, deri në një vendim të Gjykatës Kushtetuese, ta kërkoj pezullimin e këtij vendimi”, pati deklaruar Haradinaj.<sup>51</sup>

Ai kishte shtuar se pas kësaj, shqetësuese për ekzekutivin kosovar është se nga ky pezullim do të preken edhe gjykatësit dhe prokurorët. “Shqetësimi im dhe i Qeverisë është se ky pezullim godet më së shumti gjyqtarët dhe prokurorët, duke qenë se pagat e tyre janë të ndërlidhura drejtpërdrejt me vendimin për nivelizimin e pagave”, pati thënë kryeministri.<sup>52</sup>

Një qasje e tillë, bie në kundërshtim me praktikën dhe standardet ndërkombëtare, pjesë e të cilave është edhe vet Republika e Kosovës. IKD rikujton se pagat dhe kompensimi i gjykatësve dhe prokurorëve janë kategori ligjore dhe për të njëjtat nuk mund të krijohen praktika të kundërligjshme nga pushteti ekzekutiv, ku rritja e të ardhurave të gjykatësve dhe prokurorëve, bazohet në vullnetin e ekzekutivit, përmes vendimeve ad hoc.<sup>53</sup>

Më 11 qershor 2018, Gjykata Kushtetuese mori vendim lidhur me kërkesën e 30 deputetëve mbi vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të Qeverisë. Sipas Kushtetueses, vendimi i Qeverisë i 20 dhjetorit 2017, nuk është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.<sup>54</sup>

Ky vendim i Gjykatës Kushtetuese ka nxitur reagime të shumta nga opinion publik dhe njohës të çështjeve ligjore. Ndaj këtij vendimi kishte reaguar edhe IKD, duke e vlerësuar të padrejtë dhe të pabazuar, për të cilin vendim edhe vet gjykatësit e Gjykatës Kushtetuese kishin konflikt interesi, sepse rritja e pagave afektonte edhe gjykatësit e kësaj gjykate.

---

<sup>50</sup> Reagim i Kryetarës së Komisionit për Legjislacion nga VV, znj. Albulena Haxhiu, në rrjetin social facebook.com. 29 janar 2018. (Shih linkun <https://www.facebook.com/hapeporten/posts/1732825913454859> )

<sup>51</sup> “Kryeministri Haradinaj pezullon përkohësisht vendimin për rritjen e pagave”. Betimi për Drejtësi. 31 janar 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kryeministri-haradinaj-pezullon-perkohesisht-vendimin-per-rritjen-e-pagave/> )

<sup>52</sup> Po aty

<sup>53</sup> “Loja e kundërligjshme të Kryeministrit me pagat”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. (Shih linkun <http://kiks.org/loja-e-kunderligjshme-e-kryeministrit-me-pagat/> )

<sup>54</sup> “Gjykata Kushtetuese nuk gjen shkelje në vendimin e kryeministrit Haradinaj për rritjen e pagave”. Betimi për Drejtësi. 11 qershor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-kushtetuese-nuk-gjen-shkelje-ne-vendimin-e-kryeministrit-haradinaj-per-rritjen-e-pagave/> )

Gjykata Kushtetuese përmes këtij vendimi, ka legjitimuar ekzekutivin dhe politikën e aktit të kryer të saj. Me këtë hap Kushtetuesja e ka “shndërruar” pushtetin ekzekutiv në ligjvënës, ndërsa pushtetin ligjvënës e shtynë në heshtje sa i përket pagave publike, duke e detyruar që në të ardhmen çdoherë në Ligjin për Buxhetin ta lërë një mundësi të hapur për rritjet potenciale të rrogave përmes vendimeve arbitrare të Qeverisë. Për më tepër, në rastin konkret, Gjykata fare nuk ka qenë e vetëdijshme se nuk ka ligj për pagat dhe se udhëzimi i saj për Qeverinë për të zbatuar ligjin, përbën një hipokrizi dhe mosnjohje të zinxhirit të infrastrukturës ligjore kosovare në lëmin e rrogave.<sup>55</sup>

Lidhur me vendimin e Qeverisë, përkatësisht Gjykatës Kushtetuese, pati reagime të shumta edhe nga partitë politike në Kosovë, mbi të gjitha nga ato opozitare. “Ky vendim i Qeverisë për rritje të pagave është jo ligjor dhe jo kushtetues, jam habitur me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, vendimi bie ndesh me ligjin për financa publike dhe me ligjin vjetor të buxhetit të vitit 2018”, pati thënë Avdullah Hoti, shefi i grupit parlamentar të LDK – së.<sup>56</sup>

Ndërkohë, Lëvizja Vetëvendosje kishte dorëzuar në Prokurorinë Themelore të Prishtinës, kallëzimin penal për atë që sipas tyre përbën vendim të padrejtë dhe të paligjshëm të Qeverisë së Kosovës.<sup>57</sup> Kallëzimi penal tashmë gjendet në PSRK dhe ende nuk ka asnjë informacion në publik, nëse kjo prokurori ka vepruar në drejtim të hetimit dhe ndjekjes së veprës penale të konfliktit të interesit, për të cilën AKK veçse kishte paralajmëruar se do të konsumohet në rast se ky vendim zbatohet, gjë që ka ndodhur në praktikë.

Për çështjen e pagave, nuk pati mospajtime vetëm nga opozita. Tre ministrat, Bedri Hamza, Abelard Tahiri dhe Besim Beqaj kanë refuzuar pagën me rritje. Ata nuk e kishin proceduar listën e pagave në Ministrinë e Administratës Publike, rrjedhimisht pagat e tyre mbesin ashtu siç kanë qenë.<sup>58</sup>

Marrja e vendimeve të tilla si në rastin e rritjes së pagave nga ana e Qeverisë, vlerësohet se ka ndikim mjaft negativ në fusha specifike por edhe në avancimin e shtetit në përgjithësi.

Përfundimisht, përderisa nuk ndryshon mendësia e pushtetit ekzekutiv, i cili përmes vendimeve të kundërligjshme krijon privilegje për pushtetarët dhe krijon pasiguri juridike në sistemin e

---

<sup>55</sup> “Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese për vendimin e pagave të pushtetarëve ka prezumuar kushtetutshmërinë e vendimit arbitrar të qeverisë”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. (Shih linkun <http://kli-ks.org/aktgjykimi-i-gjykatës-kushtetuese-per-vendimin-e-pagave-te-pushtetareve-ka-prezumuar-kushtetutshmerine-e-vendimit-arbitrar-te-qeverise-2/> )

<sup>56</sup> “Hoti: Vendimi i Qeverisë për rritjen e pagave joligjor dhe jokushtetues (Video). Telegrafi.com. 14 qershor 2018. (Shih linkun <https://telegrafi.com/hoti-vendim-qeverise-per-rritjen-e-pagave-joligjor-dhe-jokushtetues-video/>)

<sup>57</sup> “Vetëvendosje dorëzoi në Prokurori kallëzimin penal për rritjen e pagave”. Telegrafi.com. 28 qershor 2018. (Shih linkun <https://telegrafi.com/vetevendosje-dorezoi-ne-prokurori-kallezimin-penal-per-rritjen-e-pagave/>)

<sup>58</sup> “Ekskluzive: Pos Bedri Hamzës, edhe tre Ministra refuzojnë pagën me rritje”. Gazeta Express. 30 qershor 2018 (Shih linkun <https://www.gazetaexpress.com/lajme/ekskluzive-pos-bedri-hamzes-edhe-tre-ministra-refuzojne-pagen-me-rritje-553859/?archive=1>)

pagave në sektorin publik, sidomos tek gjykatësit dhe prokurorët, dëshmon që logjika e instaluar e ndërhyrjes dhe degradimit mbi pushtetin gjyqësor është duke vazhduar.<sup>59</sup>

#### 4) Dështimi i Policisë: Vjedhja e dhomës së dëshmime

Ndër skandalet më të mëdha që kanë përfshirë Policinë e Kosovës janë vjedhjet e Dhomës së Dëshmime në këtë institucion. Dy herë në Dhomat e Dëshmime të Policisë, njëherë në Prishtinë dhe njëherë në Pejë janë vjedhur dëshmi të shumta, ndërsa rastet kanë mbetur ende të pazbardhura. Këto skandale kanë zbehur në masë të madhe besueshmërinë e Policisë së Kosovës, si një ndër institucionet më të besueshme publike në Republikën e Kosovës.

##### 4.1) Vjedhja në Dhomën e Dëshmime në Drejtorinë e Krimit të Organizuar në Polici

Në mes të 24 dhe 25 prillit 2009, dhoma e dëshmime të Drejtorisë së Krimit të Organizuar të Policisë së Kosovës, në Prishtinë, ishte thyer dhe nga aty ishin vjedhur 47.627 kg heroinë; 3828.50 euro; 520 rupi indiane; 6.500.000 lira turke; 5000 lej rumune; 950 lek shqiptarë; dhe një qese e zezë e madhësisë 70 x 35cm, me të cilën besohet se janë bartur gjësendet e vjedhura. Përveç këtyre, nga dhoma e dëshmime të DKKO-së, janë vjedhur dëshmi kyçe të konfiskuara nga hetimet në vazhdim e sipër.<sup>60</sup>

Më 28 prill 2009, u lëshua vendimi për fillimin e hetimeve, fillimisht kundër tre të pandehurve, por më vonë prokuroria dhe policia i zgjeroi hetimet në gjithsej 13 të pandehur.<sup>61</sup>

Më 19 korrik 2010, sipas kërkesës së Prokurorisë, Gjykata Supreme e Kosovës kishte vendosur për vazhdimin e hetimit deri më 27 janar 2011.<sup>62</sup>

Megjithatë, edhe këto zgjatje të afateve për hetim nuk dhanë ndonjë rezultat. Më 13 dhjetor 2010 prokuroria vendosi për pezullimin e hetimeve lidhur me këtë çështje. “Pezulloj hetimin kundër të pandehurve të përmendur në rastin penal PPS 153/2009, që nga sot 13 dhjetor 2010”, thuhej në vendimin e prokurorit të çështjes.<sup>63</sup>

---

<sup>59</sup> “IKD: Ligji për Pagat në Sektorin Publik, paraqet ndërhyrje në drejtësi, krijon pasiguri juridike dhe krijon konglomerat në sistemin e pagave në sektorin publik”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. 3 tetor 2018. (Shih linkun <http://kli-ks.org/ikd-ligji-per-pagat-ne-sektorin-publik-paraqet-nderhyrje-ne-drejtesi-krijon-pasiguri-juridike-dhe-krijon-konglomerat-ne-sistemin-e-pagave-ne-sektorin-publik/>)

<sup>60</sup> “Ekskluzive: Dhëndrri i Shpend Maxhunit, Florim Maloku, bashkë me Fadil Syleviqin dhe 11 të tjerë ishin të dyshuar për vjedhje në dhomën e dëshmime të DKKO-s (Dokument)”. Pa rrotlla. 23 tetor 2018. (Shih linkun <https://www.parrotlla.net/ekskluzive-dhendrri-i-shpend-maxhunit-florim-maloku-bashke-me-fadil-syleviqin-dhe-11-te-tjere-ishin-te-dyshuar-per-vjedhje-ne-dhomen-e-deshmive-te-dkko-s-dokument/>)

<sup>61</sup> Po aty

<sup>62</sup> Po aty

<sup>63</sup> “Ja se si u vodh dhoma e dëshmime në Policinë e Kosovës”. Drenica press. 31 tetor 2015. (Shih linkun <https://drenicapress.info/ja-se-si-u-vodh-dhoma-e-deshmive-ne-policine-e-kosoves/>)

Pas dështimit të autoriteteve kosovare për ndriçimin e këtij rasti, ishin hetuesit e EULEX-it ata që e morën në duar këtë çështje, por as këta nuk arritën të zbardhin rastin, që atëbotë ishte cilësuar si “vjedhje spektakolare”.<sup>64</sup>

Burime brenda Policisë së Kosovës kanë thënë se rasti i vjedhjes në dhomën e dëshmive në Prishtinë nuk mund të zbulohet kurrë, pasi policia asnjëherë nuk ka marrë të dhënat e duhura nga vendi i ngjarjes, sepse mungojnë elementet kryesore të gjetjes së autorëve, si shenjat e gishtërinjve, fotografitë fillestare dhe detaje të tjera.<sup>65</sup>

Në anën tjetër, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, në një intervistë dhënë emisionit “Betimi për Drejtësi”, tha se për shkak të numrit të madh të zyrtarëve policor dhe Policisë së Kosovës si organizatë, mund të ndodhin raste të tilla. “Është fakt që vjedhja në dhomën e dëshmive e ka dëmtuar Policinë e Kosovës, e ka dëmtuar edhe vendin në përgjithësi, meqenëse ka qenë një rast shumë i ndjeshëm, që në opinion është debatuar mjaft, pra edhe dëmi që i ka shkaktuar vendit. E di që ky rast është hetuar nga kolegët e EULEX – it dhe tani është transferuar tek prokurorët vendorë dhe besoj që ky rast do të hetohet në vazhdimësi, duhet ta hetojmë me prioritet, meqenëse vendi është dëmtuar mjaft nga një incident i tillë”, deklaroi Rashit Qalaj.<sup>66</sup>

IPK qysh në vitin 2007, më shumë se dy vjet para se të ndodhte vjedhja e dhomës së dëshmive, kishte nxjerrë një raport, ku thuhet se përkundër që në këtë dhomë në asnjë mënyrë nuk guxon të ketë prani të personave të pa autorizuar, studentët e kolegjeve “Fama” dhe “AAB”, po hynin në laboratorin e forenzikës pa protokoll, pasi që disa zyrtarë policor ligjëronin në të njëjtën kohë në ato kolegje.<sup>67</sup>

#### **4.2) Vjedhja në Dhomën e Dëshmive në Polici në Pejë**

Jo shumë vite pas vjedhjes së ashtuquajtur spektakolare në dhomën e dëshmive të Policisë së Kosovës në Prishtinë, një rajon tjetër u prek nga një vjedhje e përmasave të ngjashme.

Në dhomën e dëshmive në Policinë e Pejës u vodhën rreth 25 kg ari dhe përkundër reagimit të hetuesisë dhe policisë më shpejtë sesa herën e parë, megjithatë edhe ky rast ende ka mbetur pa u zgjidhur. “Ajo ka ndodhur në mënyrë shumë profesionale. Në dhomën e dëshmive nuk ka asnjë dëmtim dhe nuk ka as shenja të gishtërinjve. Mendoj që nuk ka mundur të merrej ajo sasi për një kohë të shkurtër, por ka vazhduar kohë pas kohe”, kishte thënë Jetullah Aliu, drejtor i

---

<sup>64</sup> “EULEX-i dështoi për vjedhjen në Polici”. Kosova Haber. 24 prill 2012. (Shih linkun <http://www.kosovahaber.net/?page=1,12,12205>)

<sup>65</sup> “Rastin e vjedhjes në polici e shkatërroi policia”. Telegrafi.com. 12 qershor 2012. (Shih linkun <https://telegrafi.com/rastin-e-vjedhjes-ne-polici-e-shkaterroi-policia/>)

<sup>66</sup> “Çfarë thotë Qalaj për skandalet në Polici si vjedhja në dhomën e dëshmive dhe të tjera skandale? (Video)”. Betimi për Drejtësi. 14 nëntor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/cfare-thote-qalaj-per-skandalet-ne-polici-si-vjedhja-ne-dhomen-e-deshmive-dhe-te-tjera-skandale-video/>)

<sup>67</sup> “Ikni policia! .Çohu. 6 dhjetor 2012. (Shih linkun <http://preportr.cohu.org/sq/hulumtime/ikni-policia-85>)



Departamentit të Hetimeve në Inspektoratin Policor të Kosovës. Prandaj, sipas tij, përgjegjësia kryekëput bie tek personat kompetentë.<sup>68</sup>

Por nuk është vetëm ari që dyshohet se është vjedhur, hetimet pritet të tregojnë se aty mungojnë edhe gjëra të tjera. Në atë dhomë gjendeshin edhe rreth 100 mijë euro para, por ato nuk janë prekur.<sup>69</sup>

Lidhur me këtë rast ishin arrestuar katër persona që dyshoheshin se janë të përfshirë në kryerjen e kësaj vepre penale në mënyrë shumë profesionale. Këta janë zyrtarë policorë, në mesin e të cilëve një major, dy togerë dhe një zyrtar policor.<sup>70</sup>

Përkundër faktit që nga IPK-ja ishte bërë e ditur se hetimet do të vazhdojnë deri në ndriçimin e plotë të këtij rasti, kanë kaluar më shumë se gjashtë vjet dhe ende nuk ka diçka konkrete në këtë drejtim.

## 5) Përpjekjet për të amnistuar djalin e dyshuar të Shefit të AKI-së Shpend Maxhuni

Më 12 tetor 2018, gjatë një patrullimi rutinor, Policia e Kosovës kishte ndaluar një veturë të cilën e drejtonte Shpëtim Maxhuni, djali i Shpend Maxhunit, Shef i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë dhe ish-Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës.

Sipas raportit të policisë, derisa Shpëtim Maxhuni po e voziste një veturë, e cila është pronë e gjyshit të tij, Enverit, i është gjetur një revole e llojit “Zastava”, me një karikator dhe katër fishekë, si dhe një thikë.<sup>71</sup>

Policia e Kosovës, më 20 tetor 2018, kishte lëshuar një komunikatë për media në të cilën kishte sqaruar se në veturë, së bashku me djalin e Maxhunit, i cili drejtonte automjetin, kanë qenë edhe dy persona të tjerë dhe se në atë veturë, përpos armës ishte gjetur edhe një cigare e mbështjellë, që sipas dyshimeve të prokurorisë është substancë narkotike e tipit marihuanë.<sup>72</sup> “Gjatë vazhdimit të kontrollit të automjetit, në një pjesë të veturës është gjetur një thikë, si dhe një cigare e mbështjellë, e cila dyshohej të jetë substancë narkotike dhe një mulli i bluarjes grinder ndaj të cilave janë duke u kryer hetime”, thuhej në njoftim. Personi i dyshuar (A.K.), sipas policisë ka deklaruar se cigarja e mbështjellë e gjetur brenda në veturë, si dhe mulliri i bluarjes

<sup>68</sup> “Vjedhja pa gjurmë”. *Telegrafi*. 3 qershor 2012. (Shih linkun <https://telegrafi.com/vjedhja-pa-gjurmë/>)

<sup>69</sup> “Të dyshuarit për vjedhjen e arit në arrest shtëpiak”. *Telegrafi*. 3 qershor 2012. (Shih linkun <https://telegrafi.com/te-dyshuarit-per-vjedhjen-e-arit-ne-arrest-shtepiak/>)

<sup>70</sup> “Vidhet ari në Pejë, në pranga 4 policë”. Info arkiva. (Shih linkun <http://www.arkivalajmeve.com/Vidhet-ari-ne-Peje-ne-pranga-4-police.1047245205/>)

<sup>71</sup> “Djali i Shpend Maxhunit, ishte i armatosur “deri në dhëmbë” në momentin e arrestimit (Dokumenti ekskluziv me rastin e hapjes së rastit”. *Gazeta Blic*. Tetor 2018. (Shih linkun <https://gazetablic.com/djali-i-shpend-maxhunit-ishte-i-armatosur-deri-ne-dhembe-ne-momentin-e-arrestimit-dokumenti-ekskluziv-me-rastin-e-hapjes-se-rastit/>)

<sup>72</sup> “Policia sqaron rastin ku është përfshirë djali i shefit të AKI-së, Shpend Maxhuni”. *Lajmi.com*. 2 tetor 2018. (Shih linkun <http://lajmi.net/policia-sqaron-rastin-ku-eshte-perfshire-djali-i-shefit-te-aki-se-shpend-maxhuni/>)

grinder i përkasin atij. Ndërsa i dyshuari tjetër (R. M), sipas policisë ka deklaruar se arma është e tij dhe se i njëjti e ka harruar në veturën e apostrofuat dhe se nuk i përket të dyshuarit (Sh. M).<sup>73</sup>

Prokuroria Themelore në Prishtinë, në dy raste të ndara dha deklarata të ndryshme, lidhur me këtë çështje. Fillimisht prokurori Ibrahim Berisha, kishte deklaruar se kjo Prokurori kishte pranuar një kallëzim penal në të cilën si i dyshuar ishte djali i Shpend Maxhunit. “Dje pasdite e kemi pranuar një kallëzim penal. Kam qenë në një takim, por na ka informuar përmes telefonit policia. Unë e di që ka ardhur kallëzimi penal... siç po shifet është emri i djalit tina dhe një kushëri”, kishte deklaruar Berisha, duke folur për Shpend Maxhunin, shefin e AKI-së.<sup>74</sup>

Prokurori Berisha kishte shtuar se së bashku me Kryeprokurorin Imer Beka, menjëherë janë interesuar për rastin dhe kanë kërkuar që kushdo që e ka shkelur ligjin të vihet përballë organeve të drejtësisë.<sup>75</sup>

Në të njëjtën ditë, në një deklaratë tjetër, Berisha kishte thënë se veturën e ka drejtuar djali i Maxhunit, porse arma dhe droga nuk kanë qenë të tij. Sipas tij, arma ka qenë e kushëririt të tij, Rinor Maxhuni, ndërsa droga në cigare – e një personi të tretë.<sup>76</sup>

Kryeprokurori i Shtetit Aleksandër Lumezi, në një emision televiziv në RTK, ende pa i përfunduar hetimet Prokuroria Themelore në Prishtinë, kishte thënë se substanca e dyshuar narkotike nuk i ka takuar djalit të Shpend Maxhunit. “Ende nuk dimë se çfarë veprime konkrete kanë marrë, apo kanë kryer ndonjë vepër penale. Sipas informacioneve të policisë, droga nuk është gjetur te djali i drejtorit të AKI – së, e as arma nuk është gjetur te djali i drejtorit të AKI – së”, ka thënë Lumezi në debat.<sup>77</sup>

Pas publikimit nëpër mediat vendore lidhur me dyshimin se djali i shefit të AKI-së është i përfshirë në këtë rast penal, IPK ka nisur procedurat ndaj katër zyrtarëve policorë. “Gjurmët” se cilët policë e kanë shikuar në sistemin e të dhënave rastin “Maxhuni” janë provat që Inspektorati Policor i Kosovës synon t’i mbledhë për t’i dorëzuar në Prokurori kundër zyrtarëve të cilët mund të jenë “burimet e informacioneve” të publikuara fillimisht në “Kohën Ditore” e pastaj edhe në media të tjera.<sup>78</sup>

---

<sup>73</sup> Po aty

<sup>74</sup> “Kallëzim penal ndaj djalit të Shpend Maxhunit, kapet me drogë e armë”. Telegrafi. 20 tetor 2018. (Shih linkun <https://telegrafi.com/kallezim-penal-ndaj-djalit-te-shpend-maxhunit-kapet-droge-e-arme/>)

<sup>75</sup> Kallëzim penal ndaj djalit të Shpend Maxhunit, kapet me drogë e armë”. Telegrafi. 20 tetor 2018. (Shih linkun <https://telegrafi.com/kallezim-penal-ndaj-djalit-te-shpend-maxhunit-kapet-droge-e-arme/>)

<sup>76</sup> “Prokuroria tenton ta shfajësojë djalin e Shefit të AKI-së, armën e drogën ia lënë kushëririt të Shpend Maxhunit”. Gazeta Express. 20 tetor 2018. (Shih linkun <https://www.gazetaexpress.com/lajme/prokuroria-tenton-ta-shfajesoje-djalin-e-shefit-te-aki-se-armen-e-drogen-ia-lene-kusheririt-te-shpend-maxhunit-587164/>)

<sup>77</sup> “Arsyetimi ‘me kos’ i Aleksandër Lumezit për djalin e Shpend Maxhunit”. Bota sot. 26 tetor 2018 (Shih linkun <https://www.botasot.info/aktuale-lajme/971503/arsyetimi-me-kos-i-aleksander-lumezit-per-djalin-e-shpend-maxhunit/>)

<sup>78</sup> “Hetohen katër policë me dyshimin se zbuluan për media detajet e rastit penal të djalit të Shpend Maxhunit”. Koha.net. 25 tetor 2018. (Shih linkun <https://www.koha.net/arberi/124880/hetohen-kater-police-me-dyshimin-se-zbuluan-per-media-detajet-e-rastit-penal-te-djalit-te-shpend-maxhunit/>)

Policëve të dyshuar u janë konfiskuar telefonat, ndërsa IPK ka kërkuar bashkëpunimin e Departamentit të IT-ve për të konfirmuar se kush nga policët është futur në sistem për të kontrolluar “historinë” e Shpëtim Maxhunit. Një tjetër pistë që është duke e hetuar Policia e Kosovës janë kamerat brenda objektit.<sup>79</sup>

Së fundi është bërë e ditur se zyrtari policor Afrim Karaxha është suspenduar nga puna. IPK pas hetimeve disa javore i ka rekomanduar Drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, që të suspendojë këtë zyrtar policor për shkak të dyshimit se ka zbuluar informata të ndjeshme për media. E drejtori Qalaj, me nënshkrimin e këtij rekomandimi, e ka bërë të plotfuqishëm vendimin për suspendim.<sup>80</sup>

Kjo më së miri tregon se këto çështje tentohet që maksimalisht të mbeten larg vëmendjes së mediave dhe qytetarëve në përgjithësi. E në rast se vjen tek shfaqja e tyre dhe rrjedhimisht përballja me drejtësinë, atëherë praktika ka treguar se “të fortit” janë të amnistuar nga sistemi i drejtësisë. “Ne si IKD monitorojmë sistematikisht të gjitha rastet në sistemin gjyqësor të Kosovës dhe bazuar në gjetjet e vazhdueshme sistematike rezulton se “të fortit”, në këtë rast politikanët dhe zyrtarët e lartë shtetëror janë ata që amnistohen në tërësi nga sistemi i drejtësisë. Kjo amnisti nuk i përfshinë vetëm politikanët dhe zyrtarët por edhe familjarët e tyre”, kishte thënë Betim Musliu nga IKD për TV “Dukagjini”.<sup>81</sup>

Musliu përmend rastet me fëmijët e dy zyrtarëve të lartë, që sipas tij sistemi i drejtësisë po bën fiskultura për t’i amnistuar ata. “Në këtë rast, del që, shembull djemtë e Adem Grabovcit, pothuajse për mënyrën e njëjtë të kryerjes së veprës penale janë dënuar me dënime simbolike, ndërsa qytetarët e tjerë për vepra të njëjta janë dënuar shumë më ashpër. Njëjtë po ndodh edhe me rastin e dyshuar të djalit të Shpend Maxhunit. Kjo dëshmon për 1 milion fiskultura që bën sistemi i drejtësisë për t’i amnistuar në çfarëdo forme, apo për t’i bërë të paprekshëm politikanët dhe familjarët e tyre.”<sup>82</sup>

## **6) Sistemi i sigurisë dhe drejtësisë i pafuqishëm përballë rasteve të dhunës në familje**

Edhe pse kanë kaluar më shumë se 19 vjet nga koha kur Kosova ka dalur nga lufta, dhuna në familje mbetet akoma sfidë për autoritetet e sigurisë dhe drejtësisë së Kosovës. Vetëm deri në korrikun e vitit 2018, Policia e Kosovës kishte konfirmuar se ishin evidentuar 751 raste të dhunës në familje.<sup>83</sup>

---

<sup>79</sup> Po aty

<sup>80</sup> “Suspendohet polici Karaxha, me dyshimin se informoi “Kohën Ditore” për djalin e shefit të AKI-së”. Koha.net. 27 nëntor 2018. (Shih linkun <https://www.koha.net/arberi/131114/suspendohet-polici-karaxha-me-dyshimin-se-informoi-kohen-ditore-per-djalin-e-shefit-te-aki-se/>)

<sup>81</sup> “Djemtë e babës”, një sistem i drejtësisë që i nënshtrohet politikës (Video)”. Telegrafi. 22 tetor 2018. (Shih linkun <https://telegrafi.com/djemte-e-babes-nje-sistem-drejtjesise-qe-nenshtrohet-politikes-video/>)

<sup>82</sup> Po aty

<sup>83</sup> “Rreth 800 raste të dhunës në familje këtë vit”. Zëri. 17 gusht 2018. (Shih linkun <http://zeri.info/kronika/212238/rreth-800-raste-te-dhunes-ne-familje-kete-vit/>)

Në Kosovë, siç ndodhë në shumicën e rasteve, është krijuar një bazë e mirë ligjore, në koordinim me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e familjes nga dhuna, por problemi më i madh, mbetet te zbatimi i tyre nga institucionet përgjegjëse.<sup>84</sup>

Edhe pse legjislacioni aktual ofron përshkrime të detajuara të roleve dhe përgjegjësi të një game të institucioneve dhe organizatave për mbrojtje të viktimave të dhunës në familje, zbatimi i këtyre dispozitave ka dalë të jetë sfidues për arsye të ndryshme.<sup>85</sup>

Përkundër faktit se shumë raste janë raportuar në Policinë e Kosovës, historia ka dëshmuar se ata që kanë raportuar, më pas edhe kanë vuajtur pasojat për të cilat kanë raportuar, madje duke gjetur edhe vdekjen. Histori të tilla kanë bërë që besimi qytetar në organet e sigurisë të jetë shumë i ulët në rastet kur flitet për dhunën në familje.<sup>86</sup>

Në një rast tjetër, në ish-Gjykatën Komunale të Mitrovicës, prokurori nuk e ka hetuar raportin policor të një babai i cili, siç pohohet, e rrihte fëmijën e tij me shkop. Prokurori nuk e ka ndjekur penalisht kryerësin e pohuar të dhunës, ngaqë dosja e dorëzuar nuk ishte kompletuar nga policia, duke i munguar raporti mjekësor që mund të tregonte plagët trupore. Edhe pse policia nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme, prokuroria është dashur të kryejë obligimet e veta. Një zyrtar i policisë ka komentuar se prokurorët dhe gjykatësit, po ashtu, shpesh kanë injoruar raportimet e rasteve të dhunës në familje.<sup>87</sup>

Sipas një hulumtimi të Rrjetit të Grave të Kosovës, prokurorët, përpos që nuk kanë zbatuar legjislacionin për mbrojtjen e familjes, ata edhe e kanë zbatuar në mënyrë të gabuar atë. Gjykatësit dhe prokurorët shpesh kanë dështuar në zbatimin korrekt të legjislacionit.<sup>88</sup>

Këto edhe shumë raste të tjera dëshmojnë sesi është sfiduar sistemi i drejtësisë dhe ku ka pasur ngecje në këtë aspekt. Përkundër numrit të madh të këtyre rasteve, megjithatë dy janë rastet që në mënyrë signifikante tregojnë ballafaqimin e viktimave të dhunës në familje jo vetëm me kryerësin e dhunës, por edhe me sistemin e drejtësisë.

### **6.1. Rasti i Valbona Markut**

Më 7 gusht 2018, në derën e shtëpisë së familjes Marku, në Brekoc të Gjakovës, Pjetër Nrecaj, kishte vrarë gruan e tij Valbona Marku dhe vajzën e tij nëntë vjeçare, K.N.

Valbona Marku, një bashkëshorte dhe një nënë, kishte raportuar në vazhdimësi tek organet e shtetit, për dhunën që merrte nga bashkëshorti i saj, por shteti, dështoi që asaj dhe vajzës së saj 9 vjeçare t'i sigurojë mbrojtje.

---

<sup>84</sup> UNICEF. "Hulumtimi Cilësor mbi Normat Sociale lidhur me Dhunën me Bazë Gjinore dhe Ndëshkimin Fizik të Fëmijëve në Kosovë". Korrik 2016. Faqe 22.

<sup>85</sup> Po aty

<sup>86</sup> Po aty. Faqe 49.

<sup>87</sup> RGGK. "Siguria fillon në shtëpi". 2008. Faqe 106.

<sup>88</sup> Po aty. Faqe 85.

Kryeprokurori i Gjakovës, Ali Selimaj, kishte pohuar se prokuroria ka qenë e informuar për raportimet e tani të ndjerës lidhur me kanosjet nga bashkëshorti i saj, madje edhe vetëm pak orë para se të ndodhte vrasja. E po ashtu kishte konfirmuar edhe se Pjetër Nrecaj, më herët, kishte mbajtur edhe 30 ditë paraburgim për kanosje ndaj bashkëshortes.<sup>89</sup>

Në anën tjetër, Inspektorati Policor i Kosovës ka nisur hetimet preliminare në Drejtorinë Rajonale të Policisë së Gjakovës lidhur me këtë rast dhe ka rekomanduar suspendimin e tre zyrtarëve për neglizhencë të moskryerjes së detyrave, deri në përfundim të hetimit të këtij rasti.<sup>90</sup>

Pas më pak se dy muajsh, Prokuroria Themelore në Gjakovë, më 26 shtator 2018, kishte ngritur aktakuzë ndaj Pjetër Ndrecaj, duke e ngarkuar atë me veprat penale “vrasje e rëndë” dhe “mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve”.<sup>91</sup> Kurse, më 2 nëntor 2018, pasi i akuzuari kishte pranuar fajësinë për veprat penale që i viheshin barrë, Gjykata Themelore në Gjakovë, e kishte dënuar atë me 24 vjet burgim.<sup>92</sup>

## 6.2. Rasti i Diana Kastratit

Ishte mëngjesi i majit të vitit 2011 kur Diana Kastrati ishte nisur nga shtëpia e saj për në Fakultetin e Mjekësisë, në të cilin edhe studionte, mirëpo jo shumë metra larg shtëpisë së saj, rruga i ishte ndërprerë nga ish-bashkëshorti, i cili e kishte qëlluar me armë zjarri duke e lënë të vdekur në vend.<sup>93</sup>

Paraprakisht ajo kishte kërkuar urdhër mbrojtje nga ish-Gjykata Komunale e Prishtinës, pasi që ish-bashkëshorti i saj e kërcënonte dhe e përndiqte në mënyrë të vazhdueshme. Tri javë më vonë, ai e qëlloi me armë, derisa ajo po shkonte në ligjërata.<sup>94</sup>

Menjëherë pas kryerjes së veprës, i dyshuari Adnan Jashari, ishte arratisur nga Kosova për të përfunduar në Spanjë, në shtetin i cili ende nuk e ka njohur pavarësinë e Kosovës, duke e

---

<sup>89</sup> “Zbulohet kërcënimi që ia kishte bërë gruas Pjetër Ndrecaj, para se ta vriste”. Gazeta Express. 8 gusht 2018. (Shih linkun <https://www.gazetaexpress.com/lajme/zbulohet-kercenimi-qe-ia-kishte-bere-gruas-pjeter-marku-para-se-ta-vriste-565532/?archive=1>)

<sup>90</sup> “Policët po hetohen për neglizhencë ndaj rastit”. RTV 21. 5 shtator 2018. (Shih linkun <http://rtv21.tv/inspektoriat-policor-nis-hetimet-ndaj-policëve-per-rastin-e-vrasjes-se-dyfishte-ne-gjakove/>)

<sup>91</sup> “Ngritet aktakuzë për vrasjen e ish-bashkëshortes dhe vajzës në Gjakovë”. Betimi për Drejtësi. 27 shtator 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ngritet-aktakuze-per-vrasjen-e-ish-bashkeshortes-dhe-vajzes-ne-gjakove/>)

<sup>92</sup> “Dënohet me 24 vite burgim i akuzuari për vrasjen e dyfishtë në Gjakovë”. Betimi për Drejtësi. 2 nëntor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohet-me-24-vite-burgim-i-akuzuari-per-vrasjen-e-dyfishte-ne-gjakove/>)

<sup>93</sup> “7 vjet nga vrasja e Diana Kastratit babai i saj kërkon ekstradimin dhe dënimin e vrasësit”. Zëri. 28 qershor 2018. (Shih linkun <http://zeri.info/kronika/205132/7-vjet-nga-vrasja-e-diana-kastratit-babai-i-saj-kerkon-ekstradimin-dhe-denimin-e-vrasesit/>)

<sup>94</sup> “Cikël i egër: Sindroma e abuzimit të grave në Kosovë dhe Shqipëri”. Telegrafi. 8 nëntor 2017 (Shih linkun <https://telegrafi.com/cikel-eger-sindroma-e-abuzimit-te-grave-ne-kosove-dhe-shqiperi/>)

shfrytëzuar kështu mungesën e marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të autoriteteve spanjolle dhe atyre kosovare, për mundësinë e ekstradimit të tij në Kosovë.<sup>95</sup>

Lidhur me këtë çështje, zyrtarë të Ministrisë së Drejtësisë kishin deklaruar se kanë pranuar informacion që Adnan Jashari ishte lokalizuar në shtetin e Spanjës dhe mbi bazën e këtij informacioni MD-ja kishte përcjellë dy herë kërkesën për ekstradimin e tij, por pavarësisht kësaj nuk kishte pranuar asnjë informacion lidhur me statusin e kërkesave të saj.<sup>96</sup>

Më 17 prill 2012, familjarët e të ndjerës, parashtruan kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese, me pretendimin se Gjykata Komunale në Prishtinë nuk ka vepruar sipas Ligjit nr. 03/L-182 për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje. Rrjedhimisht, shkelja nuk është pasojë e një vendimi gjyqësor, por e mosveprimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë.<sup>97</sup>

Ndërsa, më 26 shkurt 2013, Gjykata Kushtetuese vendosi se ka pasur shkelje të së drejtës për jetë, të paraparë me nenin 25 të Kushtetutës dhe me nenin 2 të KEDNJ-së; si dhe ka pasur shkelje të së drejtës për mjete juridike, të paraparë me nenin 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe me nenin 13 të KEDNJ-së.<sup>98</sup>

Ndërsa, sa i përket mosveprimit nga ana e gjyqtarit të atëkohë Gjykatës Komunale të Prishtinës, KGJK-ja kishte njoftuar se ndaj tij është shqiptuar masë disiplinore për shkak të sjelljes së pahijshme.

#### **IV. Joefikasiteti i sistemit të drejtësisë në trajtimin e rasteve**

Sipas Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën të vitit 2018, gjyqësori është ende i nënshtuar ndaj ndikimit politik. Madje, aty thuhet se administrimi i drejtësisë mbetet i ngadalshëm dhe joefikas.<sup>99</sup>

Kosova është në një fazë të hershme në luftën kundër korrupsionit dhe ka arritur pak progres sa i përket historisë së vazhdueshme të hetimit dhe ndjekjes për raste të korrupsionit dhe krimin të organizuar në nivel të lartë, duke përfshirë dënimet përfundimtare.<sup>100</sup>

Është arritur progres edhe në konfiskimin preliminar të pasurive, edhe pse konfiskimi përfundimtar mbetet i ulët.<sup>101</sup>

Korrupsioni është gjerë i përhapur, si dhe mbetet çështje brengosëse. Nevojiten orvatje të përbashkëta për të përballur këtë problem në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe strategjike.<sup>102</sup>

---

<sup>95</sup> “7 vjet nga vrasja e Diana Kastratit babai i saj kërkon ekstradimin dhe dënimin e vrasësit”. Zëri. 28 qershor 2018. (Shih linkun <http://zeri.info/kronika/205132/7-vjet-nga-vrasja-e-diana-kastratit-babai-i-saj-kerkon-ekstradimin-dhe-denimin-e-vrasesit/>)

<sup>96</sup> Po aty

<sup>97</sup> Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (në rastin KI41/12). 26 shkurt, 2013.

<sup>98</sup> Po aty

<sup>99</sup> Komisioni Evropian. “Raport për Kosovën 2018”. Prill 2018. Faqe 4.

<sup>100</sup> Po aty

<sup>101</sup> Po aty

Korrupsioni vazhdon të përbëjë shqetësim për shoqërinë kosovare. Treguesi i Perceptimit të Korrupsionit i “Transparency International” (TPK), ka treguar një trend pozitiv prej +3 pikësh gjatë dy viteve të fundit (2016 dhe 2017). Megjithatë, sipas të dhënave të Pulsit Publik, sa i përket korrupsionit në shkallë të gjerë, është rritur përqindja e përgjithshme e qytetarëve që perceptojnë se ky lloj i korrupsionit është i pranishëm në institucione të ndryshme (31% në prill 2018, krahasuar me 20% në tetor 2017).<sup>103</sup>

Perceptimi për mbizotërimin e korrupsionit në institucionet e ndryshme të Kosovës shkon nga vlerat më të ulëta 24.5% (organizatat ndërkombëtare), tek ato më të larta 39% (dogana). Ndryshimet më të mëdha në perceptimet e qytetarëve për korrupsion vërehen në institucionet e si: doganat (39% në prill 2018, krahasuar me 23% në tetor 2017), gjykatat (39% në prill 2018, krahasuar me 25% në tetor 2017), bankat (27% në prill 2018, në krahasim me 13% në tetor 2017) dhe organizatat ndërkombëtare (24.5% në prill 2018, krahasuar me 11% në tetor 2017). Edhe pse përqindjet janë rritur në përgjithësi edhe për Policinë e Kosovës (26% në prill 2018, krahasuar me 15% në tetor 2017), ajo ende mbetet një nga institucionet me vlerat më të ulëta të perceptimit për korrupsion në shkallë të gjerë.<sup>104</sup>

Për sa i përket efikasitetit të gjyqësorit në raport me numrin e gjyqtarëve, Raporti i Progresit për Kosovën 2018, ka nxjerrë një krahasim interesant me mesataren evropiane, lidhur me këtë çështje.

Më 2017, Kosova rekrutoi 52 gjyqtarë të rinj, duke e çuar numrin e përgjithshëm të tyre në 403, pas një numri dorëheqjesh, pensionimesh dhe rekrutimesh të pakta në vitet e kaluara. Njëzet e një prokurorë të rinj janë dekretuar në janar të vitit 2018, duke e çuar numrin e përgjithshëm në 198. Tashmë janë 22.6 gjyqtarë dhe 11.1 prokurorë për 100 000 banorë. Sipas CEPEJ-it, mesatarja evropiane është 21 gjyqtarë/11 prokurorë për 100 000 banorë.<sup>105</sup>

Kjo nënkupton se tashmë nuk ka kuptim të ekzistojë arsyetimi se ka numër të vogël të gjyqtarëve dhe prokurorëve për administrimin dhe përfundimin e lëndëve.

Efikasiteti i gjyqësorit pengohet në masë të madhe nga mangësitë në legjislacionin penal. Shumë dispozita në Kodin e Procedurës Penale janë tejet të ndërlikuara dhe formaliste, duke mos lejuar hetim e ndjekje penale solide e të suksesshme. Ato duhen ndryshuar e plotësuar (për shembull afati i paraparë me ligj për hetimin e rasteve).<sup>106</sup>

Përveç këtyre, kapaciteti i dobët dhe përkushtimi i dobët i disa gjyqtarëve për të menaxhuar procedurat gjyqësore, për t'i sanksionuar palët që shkaktojnë vonesa dhe për të siguruar praninë

---

<sup>102</sup> Po aty

<sup>103</sup> UNDP. “Pulsi Publik XIV”. Qershor 2018. Faqe 12.

<sup>104</sup> Po aty

<sup>105</sup> Komisioni Evropian. “Raport për Kosovën 2018”. Prill 2018. Faqe 17.

<sup>106</sup> Po aty



e të gjitha palëve në seanca, çojnë drejt shtyrjeve të shumta të seancave dëgjimore dhe procedurave penale të tej zgjata pa arsye.<sup>107</sup>

Këto aspekte, si dhe prirja e Gjykatës së Apelit që të kthejë rastet në rigjykim tek gjykatat themelore kontribuojnë drejt një afati të zgjidhjes mesatarisht të gjatë (pra koha mesatare prej ngritjes së aktakuzës, e deri tek aktgjykimi). Këto vonesa në procedura, kombinuar me preferencën për paraburgim, kundrejt masave të tjera të sigurimit, kanë çuar drejt rasteve me periudha tejet të gjata të paraburgimit.<sup>108</sup>

Organizimi i gjykatave dhe alokimi i resurseve mbetet tek kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët e prokurorive. Sipas nevojës, gjyqtarët dhe prokurorët mund të transferohen përkohësisht. Kjo është vërtetuar të jetë vegël efektive për të mbështetur gjykatat dhe prokuroritë me mungesë stafi. Numri i punëtorëve ligjorë që ndihmojnë gjyqtarët dhe prokurorët konsiderohet i pamjaftueshëm.<sup>109</sup>

Në bazë të Kushtetutës, gjyqësori është i pavarur, megjithatë gjyqësori nuk ka ofruar gjithmonë proces të duhur. Sipas Komisionit Evropian, OJQ-ve dhe Avokatit të Popullit, administrata e drejtësisë ishte ngadalshme dhe nuk kërkonte llogari nga zyrtarët gjyqësorë. Strukturat e drejtësisë ishin subjekt i ndërhyrjeve politike me emërime të diskutueshme dhe mandate të paqarta. Efikasiteti në zgjidhjen e rasteve u përmirësua gjatë vitit, megjithatë gjykatat janë të ngarkuara me lëndë të pazgjidhura.<sup>110</sup>

Problemet kryesore të të drejtave të njeriut në Kosovë gjatë vitit 2017 ishin sulmet ndaj gazetarëve; dhuna kundër personave të zhvendosur; korrupsioni endemik i qeverisë; mungesa e pavarësisë së gjyqësorit, përfshirë dështimet e proceseve dhe zbatimin selektiv të vendimeve; dhe dhuna kundër pjesëtarëve të pakicave etnike dhe anëtarëve të komunitetit LGBTI.<sup>111</sup>

## **1. Trajtimi i rasteve të profilit të lartë të korrupsionit**

Përderisa të gjitha raportet vendore dhe ndërkombëtare, konstatojnë se korrupsioni në Kosovë është endemik dhe sistemi i drejtësisë është i kapur nga politika, në praktikë vërehen përpjekje që të hidhet hi syve para qytetarëve dhe bashkësisë ndërkombëtare për luftim të korrupsionit nga sistemi i drejtësisë. Në këtë drejtim, IKD si rezultat i monitorimit sistematik të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, ka raportuar gjetjet e vazhdueshme të ngritjes së aktakuave pa bazë, pa prova dhe pa dëshmi ndaj zyrtarëve të profilit të lartë, që në masë të madhe, këto raste kanë dështuar në shqyrtimin fillestar. Ndjekja dhe ngritja e aktakuzave ndaj personave të profilit të lartë, për të cilët edhe ka pasur vazhdimisht raportime të medias dhe shoqërisë civile për përfshirje në shkelje të ligjit apo veprimtari korruptive, është “shitur” vazhdimisht si sukses i Prokurorit të Shtetit në

<sup>107</sup> Komisioni Evropian. “Raport për Kosovën 2018”. Prill 2018. Faqe 17 – 18.

<sup>108</sup> Po aty. Faqe 18

<sup>109</sup> Po aty

<sup>110</sup> U.S. Department of State. “Kosovo 2017 Human Rights Report”. 2018. Faqe 10.

<sup>111</sup> Po aty. Faqe 1.

luftimin e korrupsionit të profilit të lartë. Në anën tjetër, dështimi i mbi 90% të këtyre rasteve në gjykata, ka ndërtuar një dikurs të ri të Prokurorit të Shtetit, në drejtim të ngritjes së akuzave ndaj gjyqësorit, për siç thonë ata, dështim të qëllimshëm të rasteve nga ana e gjykatësve.<sup>112</sup> Një dështim i tillë, ua mundëson zyrtarëve të profilit të lartë që të amnistohen dhe të mos ndiqen për veprat e njëjta penale për çka janë liruar njëherë nga gjykata.

Ka raste kur prokurorët ndonëse i kalojnë dy vjet për ta hetuar një rast deri në ngritje të aktakuzës, tërhiqen vetë në seancën e parë gjyqësore. Një veprim të tillë të prokurorisë me të dyshimtë e bën fakti se këto tërheqje bëhen sidomos tek personat e profilit të lartë.

Brenda një periudhe të shkurtër kohore, prokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Feti Tunuzliu është tërhequr nga aktakuza e dy zyrtarëve të lartë. Një javë para se ish-shefi i AKI-së të emërohej në këtë pozitë ai ishte i akuzuar nga Prokuroria Themelore për “keqpërdorim të detyrës zyrtare”. Megjithatë prokurori Tunuzliu është tërhequr nga akuza.<sup>113</sup>

I njëjti prokuror në seancën e parë është tërhequr edhe nga akuza që i kishte ngritur shefit të atëhershëm të Agjensionit Kosovar për Produkte dhe Pajisje Mjekësore, Jeton Shala.<sup>114</sup> Shala në media ishte apostrofuuar si njeri që kishte lidhje me familjen e kryeministrit të atëhershëm, Isa Mustafa.

Në vazhdim janë paraqitur disa prej rasteve më reprezentative, në të cilat prokurorët kanë ngritur aktakuza, të cilat kanë dështuar që të provohen në gjykata. Trajtimi i këtyre rasteve, në tërësi është bërë në shkelje të afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale, duke shkelur vazhdimisht të drejtat e të pandehurve në procedurë penale.

### **1.1) Enver Hasani, ish – Kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës**

Më 14 prill 2015, ishte ngritur kallëzim penal kundër Enver Hasanit, ish – Kryetar i Gjykatës Kushtetuese. Në të njëjtën ditë, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK), kishte marrë aktvendim për fillimin e hetimeve kundër të njëjtit. Ndërsa, më 13 janar 2016, PSRK – ja ka ngritur aktakuzë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kundër Enver Hasanit, për veprën penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” dhe “falsifikim i dokumentit zyrtar”.

Enver Hasani akuzohej lidhur me vendimin e Gjykatës Kushtetuese për Dekretin e Presidentes rreth vazhdimin të mandatit të tre gjyqtarëve ndërkombëtarë. Sipas kësaj aktakuze, në kohën kur Hasani ishte Kryetar i Gjykatës Kushtetuese, akuzohej se kishte shënuar emrin e gjyqtarit Robert

---

<sup>112</sup>“Kryeprokurori Lumezi konfirmon kritikën e IKD-së: “Nëse prokurorët janë duke ngritur aktakuza pa bazë dhe pa prova, na me shku në shtëpi dhe na me marr përgjegjësi” (VIDEO)”. Betimi për Drejtësi. 4 shtator 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kryeprokurori-lumezi-konfirmon-kritikat-e-ikd-se-nese-prokuroret-jane-duke-ngritur-aktakuza-pa-baze-dhe-pa-prova-na-me-shku-ne-shtepi-dhe-na-me-marr-pergjegjesi-video/>)

<sup>113</sup> Prokurori Feti Tunuzliu një javë para emërimit të Shefit të AKI-së, tërhiqet nga aktakuza kundër Driton Gashit për “keqpërdorim të pozitës zyrtare”. Betimi për Drejtësi. 8 shkurt 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurori-feti-tunuzliu-nje-jave-para-emerimit-te-shefit-te-aki-se-terhiqet-nga-aktakuza-kunder-driton-gashit-per-keqperdorim-te-pozites-zyrtare/>)

<sup>114</sup>“Prokuroria në heshtje tërhiqet nga aktakuza ndaj kreut të AKPM-së”. Telegrafi. 11 qershor 2017. (Shih linkun <https://telegrafi.com/prokuroria-ne-heshtje-terhiqet-nga-aktakuza-ndaj-kreut-te-akpm-se/>)

Carolane edhe pse ky i fundit nuk kishte marrë pjesë në shqyrtimin e kësaj çështjeje, ngase bëhej fjalë për vazhdimin e mandatit të tij.

Karakteristikë e këtij rasti është ndërrimi i shpeshtë i prokurorëve, respektivisht këtë rast nga fillimi deri në fund, e kanë trajtuar tre prokurorë nga PSRK – ja: Blerim Isufaj, Drita Hajdari dhe Abdurrahim Islami.

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur më 8 shtator 2016, Enver Hasani, para trupit gjykues ka deklaruar se rasti ndaj tij “është hakmarrje ordinere e Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi dhe shefave të tij, për shkak se Gjykata Kushtetuese e kishte rrëzuar procesin e zgjedhjes së Kryeprokurorit Lumezi”.<sup>115</sup>

Aktakuza e PSRK – së, nuk kishte arritur të kalonte as në shqyrtim gjyqësor, pasi në mungesë të provave, ajo ishte hedhur poshtë nga Gjykata e Apelit.<sup>116</sup> Edhe Gjykata Supreme si instancë e fundit gjyqësore vërtetoi pafajësinë e Hasanit duke e refuzuar si të pa bazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruar nga prokuroria, kundër vendimit të Gjykatës së Apelit.<sup>117</sup>

## **1.2) Enver Hasani, ish – Rektor i Universitetit të Prishtinës**

Më 25 korrik 2012, Policia e Kosovës kishte parashtruar kallëzim penal kundër Enver Hasanit, Albert Rakipit dhe Hakif Veliut, lidhur me dyshimet për keqpërdorime në Universitetin e Prishtinës.

Më 9 janar 2014, Prokuroria Themelore në Prishtinë kishte marrë aktvendim për fillimin e hetimeve kundër Albert Rakipit dhe Hakif Veliut. Kjo lëndë ishte hetuar nga një ekip i prokurorëve të EULEX – it dhe të Prokurorisë Themelore në Prishtinë.

EULEX – i më 12 gusht 2014 këtë lëndë e kishte transferuar në Prokurorinë Themelore në Prishtinë. Ndërsa, kjo prokurori, më 21 nëntor 2014, ia kishte transferuar këtë lëndë PSRK – së. Drita Hajdari, prokurore e kësaj prokurorie, më 14 prill 2015, kishte nxjerrë vendim për zgjerim të hetimeve, duke e përfshirë edhe Enver Hasanin, si ish – Rektor të UP – së.

Gjatë asaj kohe, zhvillohej gara për Kryeprokuror të Shtetit, ku Gjykata Kushtetuese në krye me Enver Hasanin, kishte rrëzuar procesin e zgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit, në të cilin ishte zgjedhur kandidati Aleksandër Lumezi. Aso kohe, një pjesë e anëtarëve të KPK – së kishin zhvilluar “luftë” publike me Gjykatën Kushtetuese për procesin e zgjedhjes së Kryeprokurorit. Dhe posa Gjykata Kushtetuese kishte hapur rrugë për dekretimin e Kryeprokurorit Lumezi, ndaj

---

<sup>115</sup> “Enver Hasani: Kjo aktakuzë është hakmarrje e Kryeprokurorit Aleksandër Lumezi”. Betimi për Drejtësi. 8 shtator 2016 (Shih linkun <http://betimiperdrejtesi.com/enver-hasani-kjo-aktakuze-eshte-hakmarrje-e-kryeprokurorit-aleksander-lumezi/>)

<sup>116</sup> “Hudhet aktakuza ndaj ish-kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani”. Betimi për Drejtësi. 10 janar 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/hudhet-aktakuza-ndaj-ish-kryetarit-te-gjykates-kushtetuese-enver-hasani/>)

<sup>117</sup> “Supremja e shpall të pafajshëm Enver Hasanin”. Koha.net. 4 prill 2017. (Shih linkun <https://www.koha.net/arberi/10045/supremja-e-shpall-te-pafajshem-enver-hasanin/>)

Enver Hasanit, në të njëjtën ditë, më 14 prill 2015, PSRK – ja kishte nxjerrë dy vendime për fillimin e hetimeve kundër tij.

Njëri lidhej me rastin kur kishte qenë Kryetar i Gjykatës Kushtetuese, ndërsa tjetri për kohën sa kishte qenë Rektor i UP – së. Në këtë të fundit, aktakuza kundër Enver Hasanit ishte ngritur më 31 korrik 2015 për vepra penale të korrupsionit.

Sipas aktakuzës, Enver Hasani akuzohet se në cilësinë e Rektorit të UP – së, Haki Veliu në cilësi të Shefit të Zyrës së Prokurimit në UP dhe Albert Rakipi në cilësi të Drejtorit të Institutit për Studime Ndërkombëtare (ISN), me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për këtë Institut, kishin falsifikuar kontratën origjinale lidhur me përkthimin e disa librave nga gjuha angleze në atë shqipe dhe kishin hartuar një kontratë të re, duke shfrytëzuar numrin e njëjtë të protokollit nga kontrata origjinale. Sipas kontratës origjinale, vlera e saj kishte qenë 500.000 euro, përkatësisht çmimi i pagesës për njësi 1000 fjalë 12.65 euro e stipuluar me nenin 17, ndërsa në kontratën e re sipas prokurorisë, kjo pjesë është ndryshuar në 1000 karaktere për 12.56 euro.

Pas disa seancave të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata Themelore në Prishtinë, më 18 tetor 2017, e kishte shpallur fajtor Hasanin, duke e dënuar me 1 vit burgim, dënim ky që nuk do të ekzekutohej nëse ai në periudhën dy vjeçare nuk kryen vepër tjetër penale. Kurse, Hakif Veliu e Albert Rakipi, ishin dënuar me gjashtë muaj burgim efektiv. Por, ndaj tyre dënimi me burgim, mund të zëvendësohej me gjobë në shumë prej 10 mijë eurosh.<sup>118</sup>

Pas gati një viti nga vendimi i shkallës së parë, Gjykata e Apelit, në maj të vitit 2018, kishte ndryshuar vendimin e themelores duke e liruar nga akuzat Enver Hasanin. Sipas vendimit të instancës së dytë, PSRK – ja nuk e kishte provuar se ai ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar, ndërsa vendimi ishte ndryshuar edhe për dy të akuzuarit e tjerë, pasi që Gjykata Themelore i kishte dënuar ata me nga 6 muaj burgim, përderisa ajo e Apelit, duke marrë për bazë ankesën e Prokurorisë, ua kishte shqiptuar secilit dënimin me burgim efektiv në kohëzgjatje prej 1 viti.<sup>119</sup>

Enver Hasani, në një intervistë për “Betimi për Drejtësi”, kishte thënë se shefat e Kryeprokurorit Aleksandër Lumezit, duke aluduar në Presidentin e Kosovës Hashim Thaçi, dhe Zëvendëskryeministrin dhe Ministrin e Jashtëm Behxhet Pacolli, kanë urdhëruar që me aktakuza të eliminohej nga skena politike.<sup>120</sup>

---

<sup>118</sup> “Enver Hasani dënohet me burgim me kusht dhe obligohet t’ia kthejë UP-së mbi 70 mijë euro (Video)”. Betimi për Drejtësi. 18 tetor 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/enver-hasani-denohet-me-burgim-me-kusht-dhe-obligohet-tia-ktheje-up-se-mbi-70-mije-euro/>)

<sup>119</sup> “Apeli e liron nga akuzat për korrupsion ish-rektorin e UP-së, Enver Hasani”. Betimi për Drejtësi. 15 maj 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-e-liron-nga-akuzat-per-korrupsion-ish-rektorin-e-up-se-enver-hasani/>)

<sup>120</sup> “Enver Hasani thotë se shefat e Lumezit urdhëruan eliminimin e tij nga skena politike”. Betimi për Drejtësi. 16 maj 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/enver-hasani-thote-se-shefat-e-lumezit-urdheruan-eliminimin-e-tij-nga-skena-politike/>)

Pafajësinë përfundimtare të Hasanit, lidhur me këtë rast e vërtetoi edhe Gjykata Supreme. Kjo gjykatë kishte refuzuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të cilën e kishte ushtruar Prokurori i Shtetit, megjithatë e kishte kthyer në rivendosje në Gjykatën e Apelit vendimin ndaj Hakif Veliu dhe Albert Rakipit, duke e anuluar vendimin e Apelit.<sup>121</sup>

### **1.3) Sali Mekaj, ish – Kryetar i Gjykatës së Apelit të Kosovës**

Më 31 maj 2016, PSRK – ja ka ngritur aktakuzë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kundër ish – Kryetarit të Gjykatës së Apelit dhe anëtarit të KGJK – së, Salih Mekaj, për veprën penale “keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”.

Sipas aktakuzës, Salih Mekaj, në cilësinë e personit zyrtar, (kryetar i Gjykatës së Apelit të Kosovës), ka shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin e tij zyrtar, me qëllim të përfitimit të dobisë për vete dhe për persona të tjerë.

Në aktakuzë thuhet se Mekaj i ka premtuar të pandehurës Vlora Gorani se do të angazhohet për caktimin e shqyrtimit gjyqësor në dy raste, si dhe për ri – cilësimin juridik të veprave penale, nga vepra penale më të rënda në ato më të lehta, në mënyrë që dy të pandehur në ato raste të lirohen nga paraburgimi.

Prokuroria pretendon se i pandehuri Mekaj, me këtë qëllim ka kërkuar nga gjyqtarja e njërit rast në fjalë që ta caktojë shqyrtimin gjyqësor lidhur me atë lëndë, në kundërshtim me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës.

Ndërsa, sipas aktakuzës, e pandehura Vlora Gorani me dashje e ka shtyrë të pandehurin Salih Mekaj të kryejë veprën penale, me qëllim që përmes tij ta shpejtojë caktimin e shqyrtimit gjyqësor dhe pastaj të bëhet edhe ri – cilësimi juridik i veprave penale për të pandehurin Mentor Seferaj dhe një tjetër të pandehur në një tjetër rast penal. E në këtë mënyrë të arrijë lirimin e këtyre dy personave nga paraburgimi.

Aktakuza fillestare e PSRK – së, deri në përfundim të gjykimit ndaj Mekajt dhe të tjerëve kishte pësuar disa ndryshime, kjo për shkak se në fazën e kontrollimit të saj, një pjesë të aktakuzës që e ngarkonte Mekajn me “keqpërdorim të pozitës zyrtare”, Gjykata e Apelit e hodhi poshtë. Ndërsa, vet prokurorja e rastit Drita Hajdari, gjatë shqyrtimit gjyqësor e rikualifikoi veprën penale ndaj Mekajt nga “keqpërdorim të pozitës zyrtare”, në “ushtrim të ndikimit”.

Ky proces gjyqësor, ishte rast i shënjestruar për liberalizimin e vizave, por që ishte mbajtur larg syve të publikut për shkak të vendimit të gjykatës për ta mbyllur atë për median dhe publikun.

---

<sup>121</sup> “Supremja vërteton pafajësinë e Hasanit sa ishte rektor, ky thotë se Prokurori e ndoqi pa të drejtë”. Koha.net. 2 nëntor 2018. (Shih linkun <https://www.koha.net/arberi/126585/supremja-verteton-pafajesine-e-hasanit-sa-ishte-rektor-ky-thote-se-prokurori-e-ndoqi-pa-te-drejte/>)

Gjykata më 28 maj 2018, shpalli aktgjykimin me të cilin i liroi të akuzuarit nga të gjitha akuzat.<sup>122</sup> Pas ankesës së PSRK – së, Gjykata e Apelit i kishte liruar përfundimisht nga akuzat të gjithë të akuzuarit.<sup>123</sup>

#### **1.4) Shpresa Bakija, ish – Kryeprokurore e Prokurorisë Themelore në Gjakovë**

Një rast tjetër i profilit të lartë, kur prokuroria kishte dështuar që akuzën ta paraqesë në atë formë që gjykata të nxjerrë aktgjykim dënues, ishte rasti i ish – Kryeprokurores së Prokurorisë Themelore në Gjakovë, Shpresa Bakija.

Ajo ishte akuzuar nga Prokuroria Themelore në Gjilan për tri vepra penale “shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit”, “zbulimi i fshehtësisë zyrtare” dhe “cenimi i fshehtësisë së korrespondencës dhe bazave të të dhënave kompjuterike”.

Bakija, pretendohet se në muajin qershor 2012, në cilësi të personit zyrtar, pa autorizim, i ka vënë në dispozicion personit tjetër informatën që përbën fshehtësi zyrtare. Sipas prokurorisë, këtë e ka bërë me qëllim që vetes ose tjetrit t’i sjellë dobi pasurore në mënyrë të kundërligjshme, apo me qëllim të shkakimit të dëmit personit tjetër, të dëmtuarës Xhemile Karakushi.

Sipas dispozitivit të aktakuzës, e pandehura, këtë e ka bërë në atë mënyrë, që avokatit Gëzim Baloku ia ka dhënë tabulatet e mesazheve (SMS) të siguruara në lëndën PPN.5/2012 të nxjerra përmes masave të fshehta, të cilat më pas i njëjti ia ka përcjellë personit të paautorizuar, në rastin konkret, të pandehurit tjetër Arben Arifit, në kompensim prej 250 eurosh.

Ky i fundit i hap mesazhet me përmbajtje private ia dorëzon personit tjetër, vëllait dhe axhës së të dëmtuarës me letër rekomandim në Zvicër. Po ashtu, të njëjtat, i dërgon edhe në Gjykatën Themelore në Gjilan, me qëllim të përdorimit të tyre lidhur me një vendim gjyqësor, edhe pse ka qenë e ditur se këto prova nuk kanë të bëjnë fare me çështjen konkrete. Në këtë rast pretendohet se është dëmtuar dhe cenuar rëndë integriteti i të dëmtuarës.

Pas shqyrtimit gjyqësor, Gjykata Themelore në Gjilan, në qershor të vitit 2016, në mungesë të provave e kishte shpallur të pafajshme ish – kryeprokuroren Bakija dhe një vendim të tillë e kishte vërtetuar edhe Gjykata e Apelit, në nëntor të vitit 2016, me ç’rast e kishte liruar përfundimisht Bakijan nga akuzat për korrupsion.

Bashkë me të, i akuzuar për veprën penale “cenimi i fshehtësisë së korrespondencës dhe bazave të të dhënave kompjuterike”, ishte edhe Arben Arifi, por ndaj tij Gjykata Themelore në Gjilan,

---

<sup>122</sup>“*Ish-kryetari i Apelit, Salih Mekaj lirohet nga të gjitha akuzat (Video)*. Betimi për Drejtësi. 28 maj 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryetari-i-apelit-salih-mekaj-lirohet-nga-te-gjitha-akuzat/>)

<sup>123</sup>“*Gjykata e Apelit vërteton pafajësinë e ish-kryetarit të saj, Salih Mekaj dhe tre të tjerëve*”. Betimi për Drejtësi. 23 nëntor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-e-apelit-verteton-pafajesine-e-ish-kryetarit-te-saj-salih-mekaj-dhe-tre-te-tjereve/>)

kishte marrë aktgjykim refuzues, me arsyetimin se vepra penale në fjalë ka arritur parashkrimin relativ.<sup>124</sup>

### **1.5) Mazllum Baraliu, ish – Rektor i Universitetit të Prizrenit**

Prokuroria Themelore në Prizren, më 22 tetor 2015 kishte ngritur aktakuzë në Gjykatën Themelore në Prizren, kundër Mazllum Baraliut, Adem Sallaukas dhe Halim Hazirajt, për veprën penale “keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”.

Sipas aktakuzës, të akuzuarit duke punuar në Universitetin e Prizrenit “Ukshin Hoti” (UPZ), i kanë shkëlur të drejtat e të dëmtuarit, Enver Sopjani, të cilit ia kanë ndërprerë marrëdhënien e punës megjithëse kishte kontratë valide të lëshuar nga UPZ – ja.

Në aktakuzë thuhet se Sopjani kishte kontratë valide prej datës 10.06.2011, deri më 09.06.2014, në pozitën e Prorektorit të UPZ – së, por në mënyrë të njëanshme, me vendimin të lëshuar nga Rektori i asaj kohe, Mazllum Baraliu, e të nënshkruar nga Adem Sallauka dhe Halim Haziraj, i ishte ndërprerë kontrata e punës në tetor 2011.

Pas gjashtë seancave të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata Themelore në Prizren, më 15 nëntor të vitit 2016, e kishte liruar nga akuza ish – rektorin Baraliu, e po ashtu edhe Sallaukan, ndërsa aktgjykim dënues ishte shpallur vetëm ndaj Halim Hazirajt, duke e dënuar atë me një vit burgim me kusht.<sup>125</sup>

Pas ankesave në Gjykatën e Apelit, kjo gjykatë e kishte shpallur të pafajshëm edhe Hazirajn, ndërsa e kishte vërtetuar aktgjykimin lirues ndaj Baraliut dhe Sallaukës.<sup>126</sup>

### **1.6) Nuhi Uka, ish – Kryetar i Gjykatës Themelore në Prishtinë**

Nuhi Uka, është përballur me sistemin e drejtësisë në tri raste të ndryshme, ku ai është akuzuar për “krim të organizuar”, “keqpërdorim të pozitës zyrtare” dhe “nxjerrje të kundërligjshme të vendimeve gjyqësore”.

Ish – kryetari i Gjykatës Komunale të Prishtinës, ka hedhur pas krahëve një aktakuzë që rëndonte mbi të prej kohësh. Me vendim të Gjykatës së Apelit, ai është shpallur i pafajshëm për “nxjerrje të kundërligjshme të vendimeve gjyqësore”, që ndërliidhen me prona të shtetit.<sup>127</sup>

Rasti për të cilin është shpallur i pafajshëm ka të bëjë me pronat e shtetit që ishin tjetërsuar në mënyrë të paligjshme. Vlera e tyre sipas Gjykatës ka qenë 60 milion euro. Për këtë rast ai ishte

<sup>124</sup> “Apeli vërteton aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjiilan, liron nga të gjitha akuzat ish-kryeprokuroren Shpresa Bakija”. Betimi për Drejtësi. 2 nëntor 2016. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-aktgjykimin-e-gjykates-themelore-ne-gjilan-liron-nga-te-gjitha-akuzat-ish-kryeprokuroren-shpresa-bakija/>)

<sup>125</sup> “Mazllum Baraliu lirohet nga akuza për keqpërdorim të detyrës zyrtare”. Betimi për Drejtësi. 16 nëntor 2016. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mazllum-baraliu-lirohet-nga-akuza-per-keqperdorim-te-detyres-zyrtare/>)

<sup>126</sup> “Apeli vërteton pafajësinë ndaj ish-rektorit të Universitetit të Prizrenit, Mazllum Baraliu”. Betimi për Drejtësi. 23 Maj 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-pafajesine-ndaj-ish-rektorit-te-universitetit-te-prizrenit-mazllum-baraliu/?fbclid=IwAR1k1KD7G39R5z-E-Itw7e9zbzWKDNHi3dT8zLhyCXjSacDT2O-CVyJVqEU>)

<sup>127</sup> “Apeli shpall të pafajshëm Nuhi Ukën për një nga katër rastet e korrupsionit”. Zëri. 27 maj 2016. (Shih linkun <http://zeri.info/kronika/91925/apeli-shpall-te-pafajshem-nuhi-uken-per-nje-nga-kater-rastet-e-korrupsionit/>)



dënuar me dy vjet burgim me kusht nga shkalla e parë. Megjithatë, Gjykata e Apelit e kishte ndryshuar këtë vendim duke e konsideruar atë si të pafajshëm.<sup>128</sup>

Uka, ishte shpallur i pafajshëm nga Gjykata Themelore në Prizren, në një rast tjetër që kishte të bënte me dyshimet për keqpërdorime lidhur me disa prona në Prishtinë.

Aktakuza e Prokurorisë Speciale, e ngarkonte Nuhi Ukën, për veprat penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, mashtrimit dhe krimit të organizuar. Kjo sepse, ai akuzohej se kishte shfrytëzuar ndikimin e tij në ish – Gjykatën Komunale në Prishtinë, ku ishte kryetar, për t'i mundësuar mikut të tij, përvetësimin e paligjshëm të një prone në Prishtinë.

Tutje, ai akuzohej se kishte përdorur familjarët e gruas, për të kaluar pronësinë në emër të djalit të tij. Në këtë rast, bashkë me Ukën akuzoheshin edhe Sanije Muqolli dhe Fehmi Havolli, ekspert i gjeodezisë në Drejtorinë e Kadastrit të Prishtinës, të cilët gjithashtu ishin liruar nga akuza. Ndërsa, me këtë vendim ishin dënuar me burgim me kusht Mirafete Hashani – Bislimi, Kadrije Hashani, Kimete Hashani – Ukaj, Hilmije Miftari dhe Ibadete Hashani – Cakaj.<sup>129</sup>

Edhe ky rast është bërë i formës së prerë, pasi që Gjykata e Apelit, e kishte vërtetuar vendimin e shkallës së parë.<sup>130</sup>

Në një rast tjetër, në të cilin Uka, ishte liruar nga akuza ishte rasti ku ai akuzohej se në cilësinë e Kryetarit të Gjykatës Komunale të Prishtinës, ka kryer veprën penale “pengim të procedurës apo të provuarit”.

Vendimin e shkallës së parë e kishte vërtetuar edhe Gjykata e Apelit, në shtator të vitit 2016.<sup>131</sup>

Në këtë formë, me vendimet e gjykatës kishin pushuar tri procedura gjyqësore në të cilat Prokurori i Shtetit, e kishte ngarkuar Ukën, për vepra të ndryshme penale.

Nuhi Uka, është akuzuar edhe në rastin “Tokat”, në të cilin për keqpërdorime me disa prona në Çagllavicë, janë akuzuar 22 persona, ndër të cilët edhe ish – deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Azem Syla.

Uka dhe të tjerët akuzohen se në bashkëpunim, përmes veprimtarive kriminale i kanë privuar Kosovës pronat shoqërore, duke përfshirë falsifikimin e vendimeve dhe dokumenteve zyrtare, mashtrim dhe vepra të tjera korruptive.

---

<sup>128</sup> Po aty

<sup>129</sup> “Lirohet nga akuzat ish-kryetari i Gjykatës Komunale në Prishtinë, Nuhi Uka”. Betimi për Drejtësi. 21 tetor 2016. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/lirohet-nga-akuzat-ish-kryetari-i-gjykates-komunale-ne-prishtine-nuhi-uka/>)

<sup>130</sup> “Apeli vërteton aktgjykimin ndaj Nuhi Ukës dhe të tjerëve, të akuzuar për krim të organizuar dhe korrupsion”. Betimi për Drejtësi. 18 Prill 2018. (Shih linkun [https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-aktgjykimin-ndaj-nuhi-ukes-dhe-te-tjereve-te-akuzuar-per-krim-te-organizuar-dhe-korrupsion/?fbclid=IwAR3zsK5TI0FpD\\_sFeWv3jz0JxaUDxnLXAt5mc2IiNQ35iDUXEJovawC6fRo](https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-aktgjykimin-ndaj-nuhi-ukes-dhe-te-tjereve-te-akuzuar-per-krim-te-organizuar-dhe-korrupsion/?fbclid=IwAR3zsK5TI0FpD_sFeWv3jz0JxaUDxnLXAt5mc2IiNQ35iDUXEJovawC6fRo))

<sup>131</sup> “Apeli vërteton pafajësinë e Nuhi Ukës në lidhje me ish-pronat shoqërore”. Info sot. 10 shtator 2016. (Shih linkun [http://infosot.com/apeli-verteton-pafajesine-e-nuhi-ukes-ne-lidhje-ish-pronat-shoqerore/?amp\\_markup=1](http://infosot.com/apeli-verteton-pafajesine-e-nuhi-ukes-ne-lidhje-ish-pronat-shoqerore/?amp_markup=1))

Në këtë gjykim, Uka, në cilësinë e Kryetarit të Gjykatës Komunale të Prishtinës, akuzohej për veprat penale “krim i organizuar”, “shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit”, “mashtrimi në detyrë”, “marrja e ryshfetit” dhe “nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore”.

Kjo lëndë është akoma në procedurë, por fillimisht për shkak të gjendjes së vështirë shëndetësore të Ukës, procedura ndaj tij, fillimisht, ishte veçuar. Ndërsa, më 28 shtator 2018, ai kishte ndërruar jetë dhe në këtë mënyrë, procedura ndaj tij është pushuar.<sup>132</sup>

### **1.7) Shaban Buza, Rektor i Universitetit të Gjakovës**

Ende pa kaluar në fazën e shqyrtimit të fakteve, Gjykata Themelore në Gjakovë, e kishte hedhur aktakuzën ndaj Shaban Buzës, Rektor i Universitetit të Gjakovës “Fehmi Agani”.

Kjo gjykatë, në shtator të vitit 2017, kishte konsideruar se Prokuroria Themelore në Gjakovë, nuk kishte ofruar prova të mjaftueshme që kjo aktakuzë të kalohet në shqyrtimin gjyqësor.<sup>133</sup>

Vetëm një muaj më pas, ishte Gjykata e Apelit ajo e cila e bëri të formës së prerë vendimin e shkallës së parë, me të cilin ishte hudhur aktakuza e prokurorisë dhe ishte pushuar procedura ndaj Buzës.<sup>134</sup>

Sipas aktakuzës së prokurorisë, Shaban Buza, akuzohej se në periudhën kohore prej 9 tetorit 2015 e deri më 13 shtator 2016, në cilësinë e rektorit të Universitetit të Gjakovës “Fehmi Agani”, me qëllim që vetes t’i sjellë dobi pasurore në mënyrë të kundërligjshme, si dhe t’i shkaktojë dëm universitetit, ka keqpërdorë pozitën e tij zyrtare duke tejkaluar kompetencat e tij zyrtare.

Ai akuzohej se pas inspektimit nga Inspektorati i Arsimit, është konstatuar se në mënyrë të kundërligjshme janë pranuar mësimdhënës pa dokumentacion të noterizuar, pa dokumentacion të nostrifikuar të diplomave të lëshuara jashtë Kosovës, si dhe janë pranuar asistentë të cilët e kanë kaluar moshën e paraparë me ligj.

### **1.8) Hysni Hoxha, ish – Kryetar i Organit Shqyrtues të Prokurimit**

Hysni Hoxha, ish – Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), gjatë këtij viti doli “fitimtar”, përballë tri akuzave që e ngarkonin me vepra penale që ndërlidhen me keqpërdorim të detyrës zyrtare.

Në janar të këtij viti Gjykata Themelore në Prishtinë, shpalli aktgjykim refuzues ndaj tij dhe zyrtarëve të KEK – ut, Emin Tmava, Hanefi Hajdini, Driton Pruthi, Muhamet Selmani, Njazi Thaçi, si dhe ekspertit të OSHP – së, Azem Duraku, të akuzuar për korrupsion. Ky vendim erdhi

---

<sup>132</sup> “Rasti “Toka”, arratiset Ilaz Sylja, veçohet procedura ndaj tij dhe të tjerëve që munguan në seancë”. Betimi për Drejtësi. 3 shtator 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-toka-arratiset-ilaz-sylja-vecohet-procedura-ndaj-tij-dhe-te-tjereve-qe-munguan-ne-seance/>)

<sup>133</sup> “Deklarohet i pafajshëm rektori i Universitetit të Gjakovës (Video). Betimi për Drejtësi. 17 korrik 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deklarohet-i-pafajshem-rektori-i-universitetit-te-gjakoves/>)

<sup>134</sup> “Apeli vërteton hudhjen e aktakuzës në rastin e rektorit të Universitetit të Gjakovës, Shaban Buza”. Betimi për Drejtësi. 10 tetor 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-hudhjen-e-aktakuzes-ne-rastin-e-rektorit-te-universitetit-te-gjakoves-shaban-buza/>)

pasi prokurori i EULEX – it, Paul Flynn, hoqi dorë nga ndjekja penale ndaj tyre për shkak të mungesës së provave.

Sipas kësaj aktakuze, Hoxha dhe të tjerët akuzoheshin se kanë ndikuar që të shpallnin fitues të tenderit milionësh të KEK – ut, dy kompani të cilat supozoheshin se kishin aplikuar me dokumente të falsifikuara, duke i shkaktuar kështu dëm KEK – ut.

Në një rast tjetër, Hoxha edhe pse fillimisht ishte dënuar nga shkalla e parë për “keqpërdorim të detyrës zyrtare”, ai nga shkalla e dytë u shpall i pafajshëm.

Pas vendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të datës 23 dhjetor 2016, sipas së cilit Hoxha ishte dënuar me 3 vjet burgim efektiv, mbrojtja kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit, e cila më pas ka vendosur që ta lirojë Hoxhën, me arsyetimin se i njëjti nuk e ka kryer veprën penale për të cilën ishte dënuar nga shkalla e parë.

Në këtë rast, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës e ngarkonte Hysni Hoxhën për keqpërdorim të detyrës zyrtare, pasi në cilësinë e kryetarit të OSHP – së, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore i kishte tejkaluar kompetencat e tij ligjore. Sipas aktakuzës, Hoxha, më 3 dhe 9 tetor 2014 kishte vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit të Prokurimit Publik.

Konkretisht, kjo akuzë ishte ngritur lidhur me ankesat e konzorciumeve “Caraglio SRL” dhe NTSh “Electra” të ushtruara kundër vendimit të autoritetit kontraktues KOSTT lidhur me aktivitetin e prokurimit “Instalimi i Grupeve Matëse në Kufirin në mes të KOSTT (KEK) dhe OSSh”, edhe pse për këtë ankesë, kompetent për vendosje sipas prokurorisë ishte paneli shqyrtues i OSHP – së në përbërje prej 5 anëtarëve. Vlera e këtij aktiviteti të prokurimit ishte 2,327,240.19 euro.

Hoxha i shpëtoi edhe aktakuzës tjetër të Prokurorisë Speciale, e cila sërish e ngarkonte atë me veprën penale “keqpërdorim i detyrës zyrtare”.

Bëhet fjalë për aktakuzën e ngritur ndaj tij, ndaj ekspertit shqyrtues të OSHP – së, Hysni Muhadri, ndaj pronarit të kompanisë “Conex”, Veton Fetahu dhe ndaj kontabilistit të jashtëm të kompanisë, Arsim Robelli.

Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata Themelore e Prishtinës vendosi që ta lirojë Hoxhën dhe të akuzuarit Muhadri e Robelli, me arsyetimin se nuk është vërtetuar se të njëjtit kanë kryer veprat penale për të cilat i ngarkonte prokuroria. Ndërkaq, Fetahu më herët kishte bërë marrëveshje për pranimin e fajësisë lidhur me veprat penale për të cilat akuzohej.

Aktakuza e Prokurorisë Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) e ngarkonte Hysni Hoxhën dhe Hysni Muhadrin për kryerje në bashkëpunim të veprës penale “keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”.

Sipas aktakuzës, këtë vepër, të pandehurit e lartcekur e kishin kryer në qershor të vitit 2013, Hoxha në cilësi të kryetarit të OSHP – së dhe njëherësh kryetar i Panelit Shqyrtues të Prokurimit, ndërkaq Muhadri në cilësi të ekspertit shqyrtues të OSHP – së.

Sipas dispozitivit të parë, dy të pandehurit, me dashje direkte i tejkalojnë kompetencat e tyre, pasi kompanisë së ndërtimit “Conex Group” me pronar Veton Fetahun, i sjellin dobi materiale në shumë prej 1,799,759,54 euro.

Në këtë rast, operatori ekonomik “NN Beni Construction & Jaha Company SHPK” në Viti, kishte parashtruar ankesë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i lokaleve afariste në Qytezën Pejton”. Hoxha si kryetar i OSHP – së edhe pse i njoftuar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) lidhur me disa të dhëna jo të favorshme për “Conex Group”, të njëjtat i kishte fshehur para dy panelistëve tjerë, të cilat kishin qenë të dhëna cruciale.<sup>135</sup>

### **1.9) Shyqyri Haxha, ish – Drejtor Ekzekutiv i Postës dhe Telekomit të Kosovës**

Në listën e zyrtarëve të lartë të akuzuar për vepra korruptive, por të cilët tashmë kanë një atkgjykim lirues të formës së prerë, është edhe ish – kryeshefi i PTK – së, Shyqyri Haxha.

Për akuzat e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, të cilat atë e ngarkonin për “keqpërdorim të pozitës zyrtare”, Gjykata Themelore në Prishtinë, më 4 nëntor 2016, në mungesë të provave e kishte shpallur Haxhën të pafajshëm.<sup>136</sup>

Vendimin e shkallës së parë e kishte vërtetuar edhe Gjykata e Apelit, duke e liruar përfundimisht Haxhën nga akuzat që e rëndonin.<sup>137</sup>

Sipas aktakuzës së ngritur në nëntor të vitit 2014, Shyqyri Haxha, akuzohej se gjatë viteve 2009 – 2011 në cilësinë e Kryeshefit Ekzekutiv të PTK – së, ka zbatuar Rezolutën e Bordit të Drejtorëve të PTK – së, përkatësisht ka mbuluar shpenzimet e qirasë për stafin e PTK – së që jetojnë jashtë Kosovës. Në këtë mënyrë, sipas aktakuzës, kishte përfutur në mënyrë të kundërligjshme pagesën e qirasë si dhe të ngarkesave të tjera, të cilat kanë një vlerë prej 2000 euro për çdo muaj, e që në total arrinin shumën prej 53.000 eurove.

“Ka qenë vendim i pritshëm, por megjithatë është vendim i mirëpritur kur vjen nga një institucion. E gjitha ka qenë një keqkuptim”, kishte thënë Haxha, pasi që ishte shpallur i pafajshëm.<sup>138</sup>

---

<sup>135</sup> “Spektaklet dhe dështimet e aktakuzave dhe gjykimeve për korrupsion gjatë vitit 2017”. Betimi për Drejtësi. 6 Janar 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/spektaklet-dhe-deshtimet-e-aktakuzave-dhe-gjykimeve-per-korrupsion-gjate-vitit-2017/>)

<sup>136</sup> “Shpallet i pafajshëm ish-kryeshefi i PTK-së, Shyqyri Haxha”. Betimi për Drejtësi. 4 nëntor 2017 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shpallet-i-pafajshem-ish-kryeshefi-i-ptk-se-shyqyri-haxha/>)

<sup>137</sup> Po aty

<sup>138</sup> “Haxha: E dija se do të shpallëm i pafajshëm”. Gazeta Express. 4 nëntor 2016 (Shih linkun <https://www.gazetaexpress.com/lajme/haxha-e-dija-se-do-te-shpallim-i-pafajshem-274838/?archive=1>)

### **1.10) Driton Gashi, ish – Shef i Agjencisë së Inteligjencës së Kosovës**

Prokurorit Feti Tunuzliu as dy javë nuk i kanë mjaftuar që të bëhet pishman për aktakuzën e ngritur ndaj Sekretarit të Përhershëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Driton Gashi.

Aktakuzën ndaj këtij të fundit, Tunuzliu e kishte ngritur në maj 2016, ndërsa në seancën fillestare të ftuar më 27 dhjetor 2016, për të cilën kishte raportuar “Betimi për Drejtësi”<sup>139</sup>, nuk ishin paraqitur as prokurori Tunuzliu e as i pandehuri Gashi. Seanca fillestare ishte mbajtur tek më 18 janar 2017, ku prokurori kishte paraqitur aktakuzën si të qëndrueshme para Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Ndërkohë, pas vetëm 13 ditësh, më 1 shkurt, prokurori Tunuzliu përmes një parashtrese e kishte njoftuar kryetarin e trupit gjykues, Arben Hoti, se kërkon të tërhiqet nga aktakuza. Në arsyetim prokurori ka thënë se nuk ka prova të mjaftueshme, për ta mbështetur dyshimin e bazuar se Gashi, e kishte kryer veprën penale me të cilën e ngarkonte aktakuza. “Pas seancës fillestare prokurori përmes parashtesës ka njoftuar se në përputhje me nenin 52 të Kodit të Procedurës Penale ka tërhequr aktakuzën dhe ne kemi vepruar në përputhje me ligjin duke pushuar procedurën penale”, ka thënë gjykatësi Hoti për “Betimi për Drejtësi”.

Vetëm një javë pas tërheqjes nga aktakuza, Driton Gashi është emëruar në krye të AKI-së.

Aktakuza ishte ngritur duke u bazuar në kallëzimin penal që ishte iniciuar nga Udhëheqësi i Divizionit për Sigurimin e Aviacionit Civil në kuadër të MPB-së, Luan Ismajli, kundër Driton Gashit, për keqpërdorim të pozitës zyrtare. Ismajli këtë e kishte bërë, pasi që, sipas aktakuzës, Gashi nga pozita e sekretarit të Përgjithshëm në MPB, me një vendim të tij, e kishte transferuar Ismajlin në një divizion tjetër, duke e ulur kështu në pozitë.

## **V. Mungesa e llogaridhënies praktike të gjykatësve dhe prokurorëve**

Sistemi gjyqësor dhe sistemi prokurorial, kanë miratuar Kodet e Etikës dhe Sjelljes Profesionale për gjykatës dhe prokurorë, shkelja e të cilave, mund të ketë për pasojë shkarkimin e tyre nga detyra. Monitorimi i zbatimit dhe ndërmarrja e masave adekuate ndaj gjykatësve dhe prokurorëve, ka ndikuar që sjelljet e tyre të pahijshme të mos ndiqen dhe të mos mbahen llogaridhënës. Procedurat disiplinore për gjykatës dhe prokurorë janë në fuqi, por zbatimi i tyre në praktikë përcillet me probleme të shumta. Fillimisht nuk ka ndjekje adekuate ndaj gjykatësve dhe prokurorëve, por edhe në rastet kur ka procedura ndaj tyre, ka vonesa të gjata, ku procedimi dhe shqiptimi i masave nuk është vërtetuar të jetë efikas dhe efektiv për të arritur qëllimin.<sup>140</sup>

---

<sup>139</sup> “Prokurori Feti Tunuzliu një javë para emërimit të Shefit të AKI-së, tërhiqet nga aktakuza kundër Driton Gashit për “keqpërdorim të pozitës zyrtare”. Betimi për Drejtësi. 8 shkurt 2017 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurori-feti-tunuzliu-nje-jave-para-emerimit-te-shefit-te-aki-se-terhiqet-nga-aktakuza-kunder-driton-gashit-per-keqperdorim-te-pozites-zyrtare/?fbclid=IwAR1fOGLZonmN1PxNammeUBC-NyV1qzmJwyGs67Inrp1xwDOMXkaqlarAVEE>)

<sup>140</sup> Komisioni Evropian. “Raport për Kosovën 2018”. Prill 2018. Faqe 16.

## 1. Performanca e gjykatësve dhe prokurorëve

Deri më tash, shumica e gjyqtarëve dhe prokurorëve e kanë kaluar vlerësimin e performancës. Niveli i profesionalizmit dhe kompetencës, sidomos tek prokurorët, është ende çështje brengosëse; disa kanë trajnim jo adekuat, ndërsa disa nuk kanë vullnetin të aplikojnë trajnimin e ndjekur dhe për të marrë përgjegjësi të plotë për rastet e tyre. Ende nuk ka ndonjë sistem efikas dhe efektiv, ku gjykatësit dhe prokurorët i nënshtrohen një vlerësimi efektiv e sistematik, të bazuar në kritere të qarta dhe ku rezultatet shërbejnë në rrugëtimin e tyre në karrierë.<sup>141</sup>

### 1.1) Vlerësimi i performancës së gjyqtarëve nga KGJK-ja

Ligji i aplikueshëm që rregullon kontrollin dhe ngritjen e llogaridhënies në sistemin gjyqësor për gjykatës e ka paraparë mekanizmin e vlerësimit të performancës për gjyqtarë dhe mekanizmin e disiplinimit të gjyqtarëve në rastet kur të njëjtit veprojnë në kundërshtim me kodin e etikës dhe sjelljen profesionale për gjyqtarë.

KGJK-ja më 30 gusht 2016, ka miratuar Rregulloren Nr. 11/2016 për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve. Kjo rregullore përcakton procedurat dhe kriteret e vlerësimit të performancës së gjyqtarëve të të gjitha niveleve në Kosovë.

KGJK-ja, po ashtu, më 6 tetor 2016, kishte themeluar edhe Komisionin për Vlerësimin e Performancës për gjyqtarë, i cili përbëhet nga 14 gjyqtarë prej të gjitha niveleve të gjykatave.

Edhe përkundër obligimit ligjor, KGJK-ja gjatë vitit 2016, nuk ka bërë vlerësimin e performancës së asnjë gjyqtari.

Vlerësimi i performancës së gjyqtarëve nga ana e Komisionit për Vlerësimin e Performancës në KGJK, kishte filluar tek në vitin 2017.

Në vitin 2017 është bërë vlerësimi i performancës i 66 gjyqtarëve, prej tyre 2 me mandat fillestar, kurse 1/3 e gjyqtarëve me mandat të përhershëm. Gjegjësisht 54 gjyqtarë të përzgjedhur sipas metodës rastësore dhe 10 të tjerë që kanë aplikuar për ngritje në detyrë.<sup>142</sup>

Gjatë vitit 2017, vlerësimi i performancës së gjyqtarëve është bërë sipas planifikimit që kishte bërë KGJK-ja dhe Komisioni për Vlerësimin e Performancës.<sup>143</sup>

Pas vlerësimit të performancës, Komisioni për Vlerësimin e Performancës, për 2 gjyqtarë me mandat të përhershëm, ka rekomanduar masën e vijimit të trajnimeve profesionale në aspektin e përpilimit të vendimeve gjyqësore, ndërsa për 2 gjyqtarë me mandat fillestar ka rekomanduar masën e vijimit të trajnimeve obligative për menaxhimin e rasteve.<sup>144</sup>

---

<sup>141</sup> Po aty

<sup>142</sup> IKD intervistë përmes postës elektronike me z. Astrit Hoti, Drejtori i Departamentit Ligjor të Sekretariatit të KGJK – së. 29 janar 2018.

<sup>143</sup> Po aty

<sup>144</sup> IKD intervistë përmes postës elektronike me z. Astrit Hoti, Drejtori i Departamentit Ligjor të Sekretariatit të KGJK – së. 30 janar 2018.

Më 27 dhjetor 2017, KGJK-ja ka nxjerrë vendimin lidhur me gjyqtarët që do t'i nënshtrohen vlerësimit të performancës gjatë vitit 2018.<sup>145</sup> Në bazë të këtij vendimi, gjatë vitit 2018 pritet që KGJK-ja të bëjë vlerësimin e performancës për 63 gjyqtarë.

Procesi për vlerësimin e performancës së 63 gjyqtarëve është në përfundim e sipër dhe në fund të këtij viti, Komisioni për Vlerësimin e Performancës pritet të dalë me një raport përfundimtar.

Edhe në këtë vit, sikurse në vitin e kaluar, pritet që ndonjë gjyqtarit t'i caktohet masa për vijimin e ndonjë trajnimit të caktuar, ndërsa po ashtu pritet që shumica dërrmuese e gjyqtarëve të kalojnë me sukses këtë proces.

Ndonëse vet fillimi i këtij procesi paraqet një avancim relativ në këtë drejtim, vlerësimi meritohet i gjyqtarëve, përkatësisht arritja e qëllimit të këtij procesi, nuk mund të thuhet se është arritur.

### **1.2) Vlerësimi i performancës së prokurorëve nga KPK-ja**

Ligji për plotësim ndryshimin e Ligjit për KPK-në, në nenin 14/b, ka përcaktuar themelimin e Komisionit për Vlerësimin e Performancës së prokurorëve. Ky komision përbëhet nga prokurorët me përvojë dhe me integritet të lartë profesional dhe personal.

KPK-ja më 29 gusht 2011, kishte miratuar Rregulloren për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve. Përmes kësaj rregullore ishin përcaktuar procedurat dhe kriteret e vlerësimit të performancës së prokurorëve.

KPK-ja po ashtu më 24 tetor 2013, kishte miratuar një rregullore të re lidhur me vlerësimin e performancës së prokurorëve. Përmes kësaj rregullore KPK-ja kishte përcaktuar qëllimin që përmes saj të bënte vlerësimin dhe përmirësimin e performancës së prokurorëve, përcaktimin e mënyrës së kryerjes së vlerësimit dhe themelimin e Komisionit për vlerësimin e performancës së prokurorëve.

Neni 4 i kësaj rregullore kishte përcaktuar po ashtu periudhën e vlerësimit të performancës për prokurorë. Kështu, prokurorët me mandat fillestar vlerësohen dy herë brenda tre vjetëve, kurse prokurorët me mandat të përhershëm, vlerësohen çdo tre vjet. Kjo rregullore po ashtu ka përcaktuar obligimin që KPK-ja për tre vjet të bëjë vlerësimin e të gjithë prokurorëve që shërbejnë në sistemin prokurorial.

Komisioni për Vlerësimin e Performancës më 2016 kishte bërë vlerësimin e performancës ndaj 22 prokurorëve me mandat të përhershëm dhe 20 prokurorëve me mandat fillestar. Procesi i vlerësimit të performancës nuk ishte përmbyllur në tërësi brenda këtij viti dhe vlerësimi i performancës për një numër të prokurorëve që duhej të kryhej më 2016, ishte bartur më 2017.

Në vitin 2017, Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve kishte vlerësuar performancën e 61 prokurorëve si dhe të 22 prokurorëve në kuadër të proceseve të trashëguara në vitin 2017.

---

<sup>145</sup> Vendimi nr. 369/2017. (Shih linkun <http://www.gjyqesori-rks.org/GetDocument/7672>)

Mirëpo, Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve nuk i ka rekomanduar KPK-së asnjë masë që t'i shqiptohet prokurorëve të vlerësuar.

Ndërsa, sipas përgjigjes së KPK-së, në planin e veprimit për vitin 2018 është planifikuar vlerësimi i performancës së 67 prokurorëve.

KPK-ja ka planifikuar që gjatë vitit 2018 të bëjë vlerësimin e performancës për 67 prokurorë, të ndarë në pesë (5) grupe në kuadër të proceseve vlerësuese.

Deri më tani (27 nëntor 2018) janë kryer 3 procese me nga 11 prokurorë (d.m.th. 33 prokurorë me mandat të përhershëm) dhe një proces me 12 prokurorë. Deri në fund të vitit mbetet të finalizohet dhe procesi i fundit (procesi 5) në të cilin për herë të parë do të vlerësohen 22 prokurorë me mandat fillestar.

Pra, deri më tani, vlerësimi i performancës është bërë ndaj 167 prokurorëve.

Numri i prokurorëve në fillim të vitit 2017 ka qenë 171 prokurorë, në fund të vitit 2017 ka qenë 177 prokurorë, ndërsa numri aktual i prokurorëve është 191 prokurorë.

Në bazë të të gjeturave të IKD-së, procesi i vlerësimit të performancës nga sistemi prokurorial ka shkuar me zvarritje të shumta ndër vite, i shoqëruar me një mos përkushtim për t'u arritur vetë qëllimi i vlerësimit të performancës.

Përkundër kësaj, bazuar në faktin se gjatë vitit 2017 Komisioni për Vlerësimin e Performancës nuk i ka rekomanduar KPK-së asnjë masë ndaj asnjë prokurori, të cilit i është bërë vlerësimi i performancës, krijohet përshtypja se më shumë kemi të bëjmë me një proces formal se sa meritator.

## **2. Disiplinimi i gjykatësve dhe prokurorëve**

Ankesat më të mëdha në sistemin e drejtësisë vazhdojnë të ngriten për sjelljet e pahijshme të gjykatësve dhe prokurorëve në trajtimin e rasteve. Përderisa, për çdo vit ka mbi 500 ankesa, të cilat parashtrihen në Zyrën e Prokurorit Disiplinor kundër gjykatësve dhe prokurorëve me pretendime për sjellje të pahijshme, në fund, ZPD arrin që një numër simbolik të këtyre parashtrësve t'i dërgojë në Komisionet Disiplinore në KGJK dhe KPK. Është paradoksale që të gjitha shqetësimet e qytetarëve, organizatave që monitorojnë sistemin e drejtësisë dhe raportet ndërkombëtare relevante të ngritin kritika për shkelje të shumta të gjykatësve dhe prokurorëve në trajtimin e rasteve dhe në të njëjtën kohë të kemi një numër simbolik të rasteve që ZPD arrin t'i vërtetojë dhe dërgojë në Këshilla për disiplinim. Kjo dëshmon se edhe ZPD, për të cilën tashmë Kuvendi i Kosovës, ka vendosur që ta shuajë si institucion të veçantë për shkak të dështimeve, ka amnistuar vazhdimisht gjykatësit dhe prokurorët nga ndjekja disiplinore. Në këtë situatë, llogaridhënia e gjykatësve dhe prokurorëve, ka mbetur çështje e paadresuar në mënyrë efektive dhe efektive përmes mekanizmave të krijuar brenda sistemit gjyqësor dhe prokurorial.



Në vazhdim janë paraqitur të dhënat statistikore të Komisioneve Disiplinore respektive në KGJK dhe KPK për trajtimin e rasteve disiplinore për gjykatës dhe prokurorë.

### **2.1) Komisioni Disiplinor i KGJK-së**

Në vitin 2017, Komisioni Disiplinor i KGJK-së dhe KGJK, ka shqiptuar masat e mëposhtme disiplinore kundër gjyqtarëve:

- 1 vendim – Pushohet procedura disiplinore për shkak të parashkrimit të pretendimit të kryerjes së sjelljes së pahijshme;
- 2 vendime – Qortim;
- 1 vendim – Qortim me udhëzim për ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese;
- 8 vendime – Lirim nga përgjegjësia disiplinore;
- 1 vendim – Suspendim i përkohshëm;
- 1 vendim – Ulje e pagës për 3 muaj, 30% nga paga mujore;
- 1 vendim – Ulje e pagës për 6 muaj, 30% nga paga mujore;
- 1 vendim – Ulje e pagës për 4 muaj, 25% nga paga mujore; dhe
- 1 vendim – Hudhet poshtë si i palejuar raporti i Zyrës së Prokurorit Disiplinor.

Në vitin 2018, Komisioni Disiplinor i KGJK-së dhe KGJK, ka shqiptuar masat e mëposhtme disiplinore kundër gjyqtarëve:

- 2 vendime – Ulje e pagës për 6 muaj, 50% nga paga mujore;
- 1 vendim – Ulje e pagës për 3 muaj, 20% nga paga mujore.

Nga këto të dhëna statistikore, shihet se përjashtimisht një rasti kur gjyqtari është suspenduar derisa të përfundojë procedura e filluar penale, në rastet e tjera, masa më e rëndë ka qenë ulja e pagës ndaj një gjyqtari.

Në këtë drejtim, deri më tash, nuk kemi as edhe një rast të vetëm të shqiptimit të një mase më të rëndë, siç është ulja në detyrë apo shkarkimi i një gjyqtari si rezultat i shkeljeve të tij disiplinore.

### **2.2) Komisioni Disiplinor i KPK-së**

Komisioni Disiplinor i KPK-së gjatë vitit 2017 ka marrë vendimet si në vijim:

- 7 vendime – Pushim i procedurës disiplinore;
- 2 vendime – Refuzim i kërkesës për suspendim/kanë dhënë dorëheqje nga detyra e prokurorit pasi që është caktuar shqyrtimi disiplinor;
- 1 vendim – Ulje e pagës për 3 muaj, 30% nga paga mujore;
- 1 vendim – Ulje e pagës për 6 muaj, 20% nga paga mujore;
- 1 vendim – Ulje e pagës për 3 muaj, 20% nga paga mujore;
- 1 vendim – Suspendim pa pagesë.

Komisioni Disiplinor i KPK-së gjatë vitit 2018 ka marrë vendimet si në vijim:

- 2 vendime – Pushim i procedurës disiplinore;
- 1 vendim – Qortim me urdhër për ndërmarrjen e veprimeve korigjuese;
- 1 vendim – Refuzim i raportit përfundimtar;
- 1 vendim – Suspendim pa pagesë;
- 1 vendim – Ulje në detyrë (nga departamenti për të mitur, në departamentin e përgjithshëm).

Nga këto të dhëna statistikore, shohim se gjatë vitit 2017 dhe 2018 ka qenë vetëm një rast kur një prokuror është ulur në detyrë, përderisa në KPK nuk ka pasur asnjëherë asnjë rast kur një Prokuror është shkarkuar për shkak të shkeljeve të tij disiplinore.

### **2.3) Raportimi i kryetarëve të Gjykatave në KGJK**

Bazuar në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, kryetarët e Gjykatave Themelore në baza vjetore i dërgojnë KGJK – së një raport mbi suksesin e zbatimit të planit të mëparshëm vjetor për menaxhimin e lëndëve. Po ashtu, sipas ligjit, Kryetari i Gjykatës Themelore i dërgon KGJK – së raport tremujor me shkrim, që adreson punën e Gjykatës, identifikon çfarëdo problemesh me të cilat ballafaqohet Gjykata, si dhe propozon hapa riparues për të adresuar problemet e tilla.

Sa i përket vitit 2017, Kryetarët e të gjitha Gjykatave Themelore dhe Kryetari i Gjykatës së Apelit kanë raportuar dhe mbrojtur raportin vjetor për vitin 2016 para KGJK – së.

Me përjashtim të Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë, të gjithë Kryetarët e Gjykatave Themelore kanë raportuar dhe mbrojtur para KGJK – së raportin e tyre të punës për tre mujorin e parë të vitit 2017.

Por, për tremujorin e dytë, tremujorin e tretë dhe atë të katërt, Kryetarët e Gjykatave Themelore nuk kanë raportuar dhe mbrojtur para KGJK – së raportet e tyre tremujore.<sup>146</sup>

Gjendje e njëjtë është edhe në vitin 2018. Këtë vit, Kryetari i Gjykatës Supreme dhe ai i Gjykatës së Apelit kanë raportuar para anëtarëve të KGJK – së për punën e këtyre gjykatave gjatë vitit 2017.

Ndërsa për periudhën e njëjtë kohore, si dhe për 3 mujorin e parë të këtij viti, kanë raportuar të gjithë kryetarët e Gjykatave Themelore. Ndërsa për tremujorin e dytë dhe të tretë të këtij viti, kryetarët e Gjykatave Themelore nuk kanë raportuar para anëtarëve të KGJK – së.

### **2.4) Raportimi i kryeprokurorëve në KPK**

KPK-ja më 29 dhjetor 2015, ka miratuar Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Funkcionimin e Prokurorit të Shtetit.

<sup>146</sup> Disa nga Kryetarët e Gjykatave kanë dërguar raportet e tyre me shkrim për çdo tremujor, por të njëjtit nuk janë ftuar nga KGJK – ja, që të raportojnë para saj.

IKD intervistë përmes postës elektronike me z. Astrit Hoti, Drejtori i Departamentit Ligjor të Sekretariatit të KGJK – së, 8 dhjetor 2017.

Neni 9 i kësaj rregulloreje i përcakton përgjegjësitë e kryeprokurorëve në raport me KPK-në. Ndërsa, neni 9, pika 1.4 e saj, i obligon kryeprokurorët që në baza tre mujore t'i dorëzojnë KPK-së raport me shkrim lidhur me punën e prokurorisë, vështirësitë dhe propozimin e masave lidhur me përmirësimin e performancës së prokurorisë.

Nga gjetjet e IKD-së shihet se ka munguar iniciativa e KPK-së, për të kërkuar apo ftuar kryeprokurorët e Prokurorive për të raportuar para KPK-së, duke dështuar në përmbushjen e obligimeve ligjore për të siguruar llogaridhënie.

Në vitin 2017, kryeprokurorët kanë raportuar, për punën e prokurorive për periudhën janar – mars dhe prill – qershor. Ndërsa, nuk kanë raportuar para KPK-së sa i përket periudhës korrik – shtator dhe tetor – dhjetor 2017.

Përkundër faktit që raportimi i kryeprokurorëve gjatë vitit 2017 ka qenë gjysmak dhe jo siç e kërkon ligji, gjendja është edhe më keq sa i përket vitit 2018. Kjo pasi që deri më tash (27 nëntor 2018), asnjë nga kryeprokurorët e Prokurorive Themelore nuk ka raportuar para anëtarëve të KPK-së.

## **VI. Protestat qytetare për vetingun në drejtësi<sup>147</sup>**

Si rezultat i kërcënimeve publike ndaj prokurorit të dorëhequr Elez Blakaj dhe ndërhyrjeve të politikës në gjyqësor, një grup i qytetarëve të Kosovës dhe aktivistë të shoqërisë civile kishin organizuar protestë me 22 gusht të vitit 2018 në Prishtinë me moton “Shkarkim Kryeprokurorit, Veting Gjyqësorit”. Sipas organizatorëve të kësaj proteste arsyeja e protestës ndërli dhej me faktin se tash është e qartë se prokuroria është në shërbim të politikës. Edhe po të ketë prokuror/e si Elez Blakaj që ka vullnet për ta luftuar korrupsionin, do të pengohet nga Kryeprokurori Aleksandër Lumezi dhe Kryeministri Ramush Haradinaj. Qytetari i Republikës në rrethana të tilla duhet të jetë në krye të përgjegjësive dhe detyrave të veta qytetare. Tash, detyrë është kërkesa për shkarkimin e Kryeprokurorit Lumezi dhe fillimin e procesit të vetingut për gjyqësorin e Kosovës. Në protestën e organizuar më 22 gusht 2018 kishin marrë pjesë me mijëra qytetarë të Kosovës.

Lidhur me gjendjen në sistemin e drejtësisë në Kosovë, kërcënimet ndaj prokurorit Blakaj dhe ndërhyrjet e politikës në sistem të drejtësisë kishte reaguuar edhe Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Në deklaratën e kësaj zyre të lëshuar më 22 gusht 2018, shprehej qëndrimi i Bashkimit Evropian se “pavarësia dhe autonomia e gjyqësorit, përfshirë prokurorinë, është e një rëndësie vendimtare në këtë kontekst dhe duhet të sigurohet”. Bashkimi Evropian ka ftuar të gjithë të përmbahen nga ndonjë sulm i mundshëm kundër institucioneve të sundimit të ligjit, duke përfshirë këtu dhe çdo koment personal apo shpifës ndaj prokurorëve apo gjyqtarëve individualë. “Deklaratat e disa politikanëve dhe prokurorëve të Kosovës në këtë drejtim minojnë parimet

---

<sup>147</sup> “Ndërhyrjet politike në sistemin e politizuar prokurorial, alarm për nevojën e vetingut në polici, prokurori dhe gjykata”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. 30 gusht 2018. (Shih linkun <http://kli-ks.org/nderhyrjet-politike-ne-sistemin-e-politizuar-prokurorial-alarm-per-nevojen-e-vetingut-ne-polici-prokurori-dhe-gjykata/>)

kryesore të sundimit të ligjit. Për më tepër, ata gjithashtu dërgojnë sinjale dekurajuese për të gjithë zyrtarët gjyqësorë që merren me raste të ndjeshme dhe të rëndësishme”.

Organizatorët e iniciativës #Protestoj, kanë mbajtur sërish protesta qytetare më 29 gusht 2018, në të cilën poashtu kanë marrë pjesë mijëra qytetarë, me kërkesat për drejtësi të pavarur, për shkarkim të Kryeprokurorit Aleksandër Lumezi, për veting gjyqësorit si dhe me kërkesën që listat e veteranëve të UÇK-së të pastrohen dhe dinjiteti i veteranëve të vërtetë të kthehet.

Protestës i kanë dalur në mbështetje edhe 14 organizata të shoqërisë civile, të cilat kanë përkrahur protestën e organizuar nga grupi i qytetarëve për shkarkimin e Kryeprokurorit të shtetit, Aleksandër Lumezi, duke thënë se letra shpjeguese e ish-prokurorit special Elez Blakaj, sinjalizon integritetin e dobët të sistemit të drejtësisë, në veçanti prokurorisë së shtetit, përballë ndërhyrjeve politike, shantazheve dhe kërcënimeve.

“Pas dorëheqjes së ish prokurorit special z. Elez Blakaj, ne si organizata të shoqërisë civile përkrahim plotësisht protestën e organizuar nga grupi i qytetarëve për shkarkimin e kryeprokurorit të shtetit z. Aleksandër Lumezi. Letra shpjeguese e z. Blakaj sinjalizon integritetin e dobët të sistemit të drejtësisë, në veçanti prokurorisë së shtetit përballë ndërhyrjeve politike, shantazheve dhe kërcënimeve, që vijnë edhe nga vetë kryeprokurori i shtetit”, thuhet në njoftim. Ndër të tjera, organizatat e shoqërisë civile kanë thënë se ndërhyrjet e Kryeprokurorit Lumezi për të shmangur përballjen e figurave të larta të politikës me procesin e drejtësisë janë alarmante për drejtësinë në Kosovë.

“Dorëheqja e kryeprokurorit Lumezi, do të rriste besimin qytetar në drejtësinë e pavarur, prandaj ne përkrahim protestën qytetare, dhe kërkojmë që përveç shkarkimit të tij të fillojë edhe procesi i vetingut në sistemin e drejtësisë sikurse në të gjitha vendet e rajonit”, theksohet në njoftim. Në njoftim thuhet se këto organizata besojnë fuqishëm se vetëm një sistem i drejtësisë i pavarur, me integritet dhe imun ndaj interferimeve të politikës do të mund të garantojë sundimin e ligjit, që është parakusht për funksionimin e shtetit demokratik.

Protesta më pas është ndalur më 12 shtator 2018 nga grupi organizativ i qytetarëve, me arsyetimin se nuk kanë parë potencial për masivizimin e protestës.

## **VII. Vetingu pa alternativë për gjykatësit, prokurorët dhe policët**

Përkundër faktit se arkitektura e institucioneve të drejtësisë dhe legjislacioni pozitiv në Republikën e Kosovës nuk ka munguar, në praktikë kanë munguar rezultatet konkrete në luftimin e kriminaliteti, ofrimit të sigurisë juridike dhe trajtimin e rasteve në kohë të arsyeshme, të drejtë, të paanshme dhe të pavarur.

Fatkeqësisht, bartja e kompetencave nga institucionet ndërkombëtare të drejtësisë tek vendorët është përcjellur me një degradim të madh të këtyre institucioneve, duke kapur politika të gjitha

institucionet dhe pozitat kyçe në sistemin e drejtësisë. Në këtë mënyrë, fajtori kryesor mbetet politika, e cila synimin e saj e ka arritur, duke kapur në masë të madhe institucionet e drejtësisë, përfshi praktikisht procesin e rekrutimit dhe emërimit të pozitave kyçe në sistemin gjyqësor dhe prokurorial. Trajtimi i rasteve të elaboruara në këtë raport, në të cilat janë të përfshira profilet e larta, dëshmon se sistemi i drejtësisë nuk ka dëshmuar vullnet për të ushtruar kompetencat dhe përgjegjësitë në bazë të Kushtetutës dhe legjislacionit pozitiv, përkundrazi ka shërbyer si amnistues i veprimeve të kundërligjshme e kriminale të zyrtarëve të profilit të lartë. Republika e Kosovës vazhdon të mbetet sinonim i një shteti ku mungon sundimi i ligjit, dhe ku kultura e pandëshkueshmërisë në rastet e profilit të lartë është standard jetese. Të korruptuarit dhe shkelësit e ligjit vazhdimisht promovohen dhe janë shndërruar në “model të suksesit” për arritje në Kosovë.

Raportet e organizatave vendore dhe ndërkombëtare që monitorojnë sistemin e drejtësisë në Kosovë, në mënyrë të vazhdueshme kanë raportuar për politizim të skajshëm të sistemit gjyqësor dhe prokurorial në Kosovë. Raportet e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën, Raportet e Departamentit të Shtetit Amerikan, konkluzionet e nëngrupeve të takimeve lidhur me MSA mes Komisionit Evropian dhe Kosovës konstatojnë mungesën e rezultateve në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë në Kosovë, politizimin e institucioneve të pavarura, përfshirë sistemin e drejtësisë, instalimin e kulturës së pandëshkueshmërisë, etj.

Publiku në Kosovë, media, OJQ-të, qytetarët, shërbyesit civil dhe administrata shtetërore në ato raste kur ballafaqohen me dukuritë e korrupsionit në Kosovë nuk kanë një adresë të besueshme për të raportuar të njëjtat. Instalimi i kulturës së pandëshkueshmërisë ka rritur mungesën e besimit që këto dukuri t’i raportojnë tek institucionet kompetente që këto raste t’i trajtojnë në mënyrë të pavarur, paanshme dhe profesionalisht.

IKD si OJQ e vetme që monitoron sistematikisht sistemin e drejtësisë në raportet e saj ka shpërfaqur problemet me të cilat përballet sistemi i drejtësisë në Kosovë, me mungesë efikasiteti, llogaridhënie, transparencë, korrupsion të brendshëm dhe mungesë të besimit nga ana e publikut. Në këtë drejtim një proces i vetingut është i pakompromis dhe rruga e vetme e depolitizimit të sistemit të drejtësisë në Kosovë. Qytetarët dhe publiku nuk e kanë luksin që të durojnë shkeljen e të drejtave dhe lirive të tyre nga një sistem i cili në vend të ndarjes se drejtësisë është shndërruar në shkelësin më të madh të të drejtave dhe lirive të qytetarit.

Në këtë situatë të krijuar, e cila shihet e pashpresë, është nevojë e domosdoshme që Kosova të fillojë me veprime konkrete drejt procesit të vetingut në Polici, Prokurori dhe Gjykata. Përmes këtij procesi duhet të sigurohen qytetarët e Kosovës se vetingu do të bëhet në mënyrë të pavarur, të drejtë dhe të paanshme. Integriteti i tërë këtij procesi do të garantohej nëse ai do të realizohej nën udhëheqjen e shteteve mike që kanë mbështetur shtet ndërtimin e Kosovës ndër vite si SHBA, Britania e Madhe dhe Gjermania.